RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËRPUTHSHMËRIE NË "KESH" SHA PROJEKTI "PLANI I RISTRUKTURIMIT TË KESH SHA"

GUSHT 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	
1.	Përshrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	5
II.	**HYRJA**	**7**
1	Objekti i auditimit.....	7
2	Qëllimi i auditimit.....	7
3	Identifikimi i çështjes.....	7
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	7
5	Përgjegjësitë e audituesve.....	7
6	Kriteret e vlerësimit.....	7
7	Standardet e auditimit.....	8
8	Metoda e auditimit.....	8
9	Dokumentimi i auditimit	8
III.	**PËRSHRIMI I AUDITIMIT.....**	9
	1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	9-9
	2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	9-9
	Pika 1. **Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve.** **1.1.** Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në miratimin e marrëveshjes së financimit. **1.2.** Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në ngritjen e strukturave për funksionimin e marrëveshjes së financimit.	9-13
	Pika 2. Mbi mënyrën e përzgjedhjes së overdrafteve për shlyerje, rradha e ndjekur, stadin e tyre në momentin e likuidimit. **2.1.** Kriteret e vendosura për shlyerjen e kredive të mëparshme të KESH SHA. **2.2.** Përcaktimi i radhës së shlyerjes së kredive. **2.3**. Mbi plotësimin e detyrimeve nga ana KESH SHA, sipas përcaktimeve në marrëveshje. **2.4**. Mbi procesin e negocimit me bankat e nivelit të dytë për mundësinë e strukturimit të borxhit sipas termave të marveshjes me BERZH.	13-25
	Pika 3. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave. **3.1.** Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në menaxhimin financiar të Projektit. **3.2.** Mbi realizimin e disbursimeve të Projektit, në krahasim me disbursimet e planifikuara. **3.3.** Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në raportimet financiare dhe jo financiare.	28-33
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET.....**	**33-36**
V.	**ANEKSE.....**	**37**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti ristrukturimit të KESH SHA, ka të bëjë me marrjen e një huaje meterma të favorshëm dhe afatgjatë përshlyerjen e overdrafteve tëarrë nga ana e KESH për pa mundësi likuidimi. Marrja e overdrafteve i ka shkaktuar humbje të konsiderueshme KESH, pasi ka qenë i detyrueshëm shlyerja e interesave për overdraftet në nivele të larta, ndërkohë që overdrafti, ose principali nuk mund të shlyhej. Për këtë arsye, Me ligjin nr. 125/2016, është ratifikuar marrëveshja ñPër ratifikimin e marrëveshjen e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropianë për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), në lidhje me marrëveshjen e Huas ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Bankës Evropiane për Zhvillim (BERZH), për projektin ñShqipëria: Plani i strukturimit të KESHò. Sipas kësaj marrëveshje, BERZH ka rënë dakord që tõ japë Huamarrësit një hua në vlerën deri 118 milionë Euro (e realizuar) dhe 100 milionë Euro (e pa realizuar), në bazë të afateve dhe kushteve të parashtruara ose të referuara në marrëveshjen e huas, por vetëm me kusht që Garantuesi duhet të sigurojë mbështetjen e nevojshme, duke përfshirë sa i përket planit të reformës dhe planit të veprimit për qeverisjen e korporatës që do të miratohet në përputhje me planin e reformës.

Të garantohen detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas, secila sipas parashikimit në Marrëveshje.

Bazuar në marrëveshjen e huas, neni 2, seksioni 2.01, huaja përbëhet nga dy këste: Kësti A në shumën deri 118 milionë Euro dhe kësti B në shumën 100 milionë Euro.

Huaja është parashikuar të shlyhet në 28 këste të barabarta gjashtëmujore (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) me 10 prill dhe 10 tetor të çdo viti, me datën e parë të shlyerjes së kredisë që do të jetë 10 tetor 2017 dhe me datën e fundit të shlyerjes së kredisë që do të jetë 10 Prill 2031.

Bazuar në nenin 2, seksioni 2.02, pika 2. g, Huamarrësi do tõ paguajë Bankës tarifën e angazhimit prej 0.5 % në vit, mbi totalin e shumës së disponueshme për çdo këst.

Huamarrësi do tõ paguajë Bankës një komision fillim-mbarim të barabartë me 1 % (ose një shumë tjetër të tillë të specifikuar në marrëveshjen e kredisë) të shumës së principalit për çdo këst.

1. Përshkrim i shkurtër i auditimit.

Auditimi është përqendruar në lidhje me menaxhimin e proceseve të marrjes së huas. Është audituar mënyra e përzgjedhjes së overdrafteve për shlyerje, pra prioritetet e ndjekura, duke vlerësuar nëse janë shlyer në fillim overdraftet me kushtet më të pafavorshme për KESH. Në marrëveshjen e financimit ka patur detyrime të cilat do të realizoheshin nga ana e KESH. Në këtë aspekt, është shqyrtuar dokumentacioni se në cfarë mase janë realizuar këto detyrime, problematikat dhe vonesat që e kanë shoqëruar. Gjithashtu, për këtë projekt është audituar dokumentacioni që ka të bëjë me ndjekjen e procedurave ligjore në menaxhimin financiar të Projektit, realizimin e disbursimeve, në krahasim me disbursimet e planifikuara, si dhe ndjekja e procedurave ligjore në raportimet financiare dhe jo financiare.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Nga auditimi është konstatuar se:

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar të auditimit.	Rëndësia	Rekomandimi

1	Nga auditimi i Marrëveshjes së Huasë së EBRD të ratifikuar me Ligjin Nr. 125/2016 "Për projektin" Shqipëria: Plani i Ristrukturimit të KESH-it" rezulton se, KESH SHA ka paguar **548,277,597 lekë** interesa overdraftesh si rezultat i mos plotësimit në kohë të kushteve të vëna nga banka për bërjen efektive të parave, vlerë e cila **e cila përbën efekt negative financiar për buxhetin e shoqërisë.**	Pika 2	E lartë	KESH SHA në të gjitha rastet të tregojë angazhim maksimal në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave apo kushteve të përcaktuara në marrëveshje si dhe te nxisë organet e tjera për plotësimin e tyre sipas rastit, me qëllim respektimin e afateve të miratuara për mënjanimin e kostove shtesë në këtë projekt të cilat deri në këtë fazë arrijnë vlerën **548,277,597 lekë**.
2	Nga auditimi u konstatua se, KESH SHA nuk ka përllogaritur humbjen që i shkaktohet nga tarifa e angazhimit për të cilën KESH SHA ka paguar shumën prej **1,066,455 Euro pas lëvrimit të tranzhit A vlerë e cila përbën efekt negative financiar për buxhetin e shoqërisë**. Për tranzhin A, KESH SHA iu kanë rritur kostot me tarifën e angazhimit si rezultati i tërheqjes me vonesë të shumës së akorduar si rezultat i mos plotësimit të kushteve të vëna nga banka, kryesisht të kushteve të tregut energjetik për tu plotësuar nga ERE, rakordimin me detyrimet që OSHEE ka ndaj KESH, rritjen e çmimit të shitjes së energjisë nga KESH sha e cila miratohet nga ERE, etj. Për Tranzhin B KESH SHA i janë rritur kostot me tarifën e angazhimit si rezultati i tërheqjes me vonesë prej 72 ditësh sipas shkresës nr. 1034 datë 03.04.2020 të EBRD me **100,000 Euro. (**100,000,000 Euro x (72/360 x 0.5%) = 100,000 Euro.**)**	Pika 2	E lartë	KESH SHA të marrë masa për angazhim maksimal në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave apo kushteve të përcaktuar si dhe te nxisë organet e tjera për plotësimin e detyrimeve të tyre të adresuara nga zbatimi i marrëveshjes, me qëllim respektimin e afateve dhe mënjanimin e kostove shtesë në këtë projekt të cilat kanë krijuar efekt financiar negativ në vlerën **1,166,455 Euro**.

3	Nga auditimi u konstatua se, për Tranzhin B, huamarrësi KESH SHA ka përdorur vetëm 89,740,094 Euro nga vlera e akorduar prej 100,000,000 Euro, ndërsa komisionet nga ana e huadhënësit janë mbajtur mbi vlerën e plotë dhe jo atë të lëvruar. Diferencën prej 10,259,906 Euro të palëvruara KESH SHA e ka negociuar me Intesa Sanpaolo Bank duke e strukturuar OD sipas kushteve të marrëveshjes me BERZH. Komisioni fillim mbarim që BERZH duhet të mbante nga TRANZHI B llogaritet në 89,740,094 Euro x 1% = 897,401 Euro ndërkohë që është mbajtur vlera prej 1,000,000 Euro ose **102,599 Euro më tepër.** Mbajtja e komisioneve bëhet sipas Nenit 2 ñAfatet Kryesore të Huasò, Seksionin 2.02 ñAfate të tjera Financiare të kredisëò, pika h), *huamarrësi do ti paguajë bankës një komision fillim-mbarim të barabartë me një përqind (1%) të shumës së principalit për çdo këst.*	Pika 2	E lartë	KESH SHA të marrë masat e nevojshme me Huadhënësin për rakordimin e shumave të mbajtura për komisionet e huasë, fillim-mbarim, dhe rikuperimin e vlerës prej **102,599 Euro** gjatë pagesave në vijim duke kryer dhe sistemimet përkatëse.

3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.

Arrihet në konkluzionin se, marrja e huas për ristrukturimin e borxhit, jep një ndikim shumë të rendësishëm për financat e KESH SHA, por për finalizimin e marrjes së huas, nuk janë marrë masat e duhura dhe për pasojë shoqëria, ka likuiduar vlera të konsiderueshme për tarifa angazhimi si dhe interesa overdraftesh, për mos vënie në eficiencë të huas në periudhën e parashikuar.

OPINIONI I AUDITIMIT

Për Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare (KESH SHA)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, sa i përket Projektit ñPlani i ristrukturimit të KESHò, mbi shkallën e zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe kushteve, mbi të cilat KESH, menaxhon proceset e zbatimit të marrëveshjes së huas.

Opinioni i modifikuar/ i kualifikuar.

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin OST SHA, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një Opinioni të modifikuar/ i kualifikuar.

Baza për opinionin e modifikuar/ i kualifikuar..
Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ***ISSAI 4000***[1]**,** me ligjin nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSH-së me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 òStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëò. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në INTOSAI - P10, ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tò, si dhe ISSAI 130 ñKodi Etikò. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetin për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e projektit, rezultuan disa mangësi dhe parregullsi të cilat kanë sjell shtesë të kostove të borxhit në vlerën totale rreth 708,533,749 Lekë[2] **dhe konsistojnë në:**

- KESH SHA ka paguar 548,277,597 lekë interesa overdraftesh si rezultat i mos plotësimit në kohë të kushteve të vëna nga banka për bërjen efektive të parave, vlerë e **e cila përbën efekt negative financiar për buxhetin e shoqërisë**.
- KESH SHA nuk ka përllogaritur humbjen që i shkaktohet nga tarifa e angazhimit për të cilën KESH SHA ka paguar shumën prej **1,166,455.10 Euro, e cila përbën efekt negative financiar për buxhetin e shoqërisë** (me vlerë 1,066,455.10 Euro pas lëvrimit të tranzhit A dhe me vlerë 100,000 Euro për tranzhin B).

Për tranzhin B, nga KESH SHA janë përdorur 89,740,094 Euro nga 100,000,000 Euro të parashikuara, pasi për diferencën vlerë 10,259,906 Euro, KESH SHA ka negociuar me Intesa Sanpaolo Bank duke e strukturuar OD sipas kushteve të marrëveshjes me BERZH. Komisioni fillim-mbarim është parashikuar në masën 1%. Komisioni fillim mbarim që BERZH për tranzhi B është përllogaritur me vlerë 1,000,000 Euro, ndërkohë që duhet të llogaritej me vlerë 897,401 Euro (89,740,094 Euro x 1%). Vlera e mbajtur më tepër është në shumën **102,599 Euro.**
Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve financiare dhe përmbushjes së objektivave, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij.

[1]Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

[2] Kursi i këmbimit për vlerat në Euro i referohet kursit të përdorur nga KESH në momentin e shlyerjes së overdraftit datë 30.05.2018, 1Euro = 126.28 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 878/1, datë 23.09.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 28.09.2020 deri me datë 30.10.2020, në subjektin ñKESHò SHA, Projekti ñPlani i Ristrukturimit të KESH SHAò për periudhën nga fillimi i projektit deri me datë 30.09.2020, u krye auditimi ñMbi zbatimin e përputhshmërisëò nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. T., përgjegjës grupi.
2. S. H.
3. M. H.

1. Objekti i auditimit

Auditimi i përputhshmërisë së Projektit ñPlani i strukturimit të KESH SHAò, përfitimet nga strukturimi i overdrafteve dhe plotësimi i kushteve për lëvrimin në kohë të huas nga Banka Evropiane për Zhvillim.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të huas së marrë nga Banka Evropiane për rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) si dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që ñKESHò SHA, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve për ristrukturimin e borxhit të krijuar në vite, si pasojë e situatave të vështira financiare, borxhe të marra në bankat e nivelit të dytë. Auditimi ka për qëllim ***promovimin e transparencës*** duke ofruar raporte të besueshme për huan nëse është administruar siç kërkohet në marrëveshjen përkatëse, duke shmangur humbjet si pasojë e mos menaxhimit siç duhet të proceseve. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim ***promovimin e përgjegjshmërisë*** ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.
Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë *(sipas ISSAI 400, p 18).*

3. Identifikimi i çështjes

Shoqëria duhet të organizojë dhe kryejë veprimet e duhura sipas përcaktimeve në marrëveshjen e huas, për realizimin e detyrimeve për përmirësime ligjore, organizim etj., në mënyrë që fondet e vëna në dispozicion nga huaja, të përdoren për shlyerjen e borxheve (overdrafteve) në periudhën e përcaktuar për të minimizuar humbjet që vijnë nga shlyerja e interesave të larta.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim

Projekti ka si qëllim shlyerjen e overdrafteve të cilat rezultojnë me interesa të larta për buxhetin e shoqërisë me fondet nga huaja, të cilat janë pa interes dhe mundësojnë shlyerjen në një periudhë të gjatë.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Të respektojë kërkesat etike, planifikojë dhe kryejë auditimin sipas nivelit të sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit

Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 ñMbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së.
Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, i ndryshuar;
Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò;
Ligji nr. 43/2015 ñPër sektorin e energjisë elektrikeò, i ndryshuar;
Ligji nr. 125/2016 ñPër ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga ministria e financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në lidhje me marrëveshjen e huas ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për projektin ñShqipëria: plani i ristrukturimit të KESHò.
VKM nr. 116, datë 24.02.1997 ñPër kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisëò;
VKM nr. 452, datë 01.07.1998 ñPër disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huajò;
Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò;
Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të shoqërisë;

7. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 – (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)
- ISSAI 400 - (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë)
- ISSAI 4000 - (Standardet e auditimit të përputhshmërisë)
- Kodi etik, rregullore e procedurave të auditimit të KLSH

8. Metoda e auditimit

Auditimi është zbatuar sipas drejtimeve në programin përkatës, mbi:
- Marrëveshjen e financimit, ndryshimet dhe shkaqet e ndryshimeve, mbi ndjekjen e procedurave ligjore në miratimin e marrëveshjes së financimit, ndjekjen e procedurave ligjore në ngritjen e strukturave për funksionimin e marrëveshjes së financimit.
- Kriteret e vendosura për shlyerjen e kredive të mëparshme të KESH SHA, përcaktimin e radhës së shlyerjes së kredive, plotësimin e detyrimeve nga ana KESH SHA, sipas përcaktimeve në marrëveshjes, procesin e negocimit me bankat e nivelit të dytë për mundësinë e strukturimit të borxhit sipas termave të marrëveshjes me BERZH.
- Menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave, ndjekjen e procedurave ligjore në menaxhimin financiar të Projektit, realizimin e disbursimeve të Projektit, në krahasim me disbursimet e planifikuara, ndjekjen e procedurave ligjore në raportimet financiare dhe jo financiare.

Janë konstatuar mangësi në zbatimin e disa detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen e financimit të cilat nuk janë detyrime që i adresohen vetëm KESH, pasojë e të cilave, overdraftet

nuk janë shlyer në periudhën e përcaktuar, duke bërë që të mos arrihen përfitimet e pritshme si dhe duke u penalizuar me pagesa të tarifës së angazhimit.
Auditimi është realizuar i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje.

9. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e të dhënave të rezultateve të auditimit të grumbulluara, janë mbajtur akt konstatimet, për të cilat janë shqyrtuar komentet dhe shpjegimeve e të subjektit të audituar. Projekt Raporti i Auditimit i hartuar do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Me ligjin nr. 125/2016, është ratifikuar marrëveshja ñPër ratifikimin e marrëveshjen e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropianë për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), në lidhje me marrëveshjen e Huas ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Bankës Evropiane për Zhvillim (BERZH), për Projektin ñShqipëria: Plani i strukturimit të KESHò.
Sipas kësaj marrëveshje, BERZH ka rënë dakord që tã japë Huamarrësit një hua në vlerën deri 118 milionë Euro (e realizuar) dhe 100 milionë Euro (e pa realizuar), në bazë të afateve dhe kushteve të parashtruara ose të referuara në marrëveshjen e huas, por vetëm me kusht që Garantuesi duhet të sigurojë mbështetjen e nevojshme, duke përfshirë sa i përket planit të reformës dhe planit të veprimit për qeverisjen e korporatës që do të miratohet në përputhje me planin e reformës.
Të garantohen detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas, secila sipas parashikimit në Marrëveshje.
Bazuar në marrëveshjen e huas, neni 2, seksioni 2.01, huaja përbëhet nga dy këste: Kësti A në shumën deri 118 milionë Euro dhe kësti B në shumën 100 milionë Euro.
Huaja është parashikuar të shlyhet në 28 këste të barabarta gjashtëmujore (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) me 10 prill dhe 10 tetor të çdo viti, me datën e parë të shlyerjes së kredisë që do të jetë 10 tetor 2017 dhe me datën e fundit të shlyerjes së kredisë që do të jetë 10 Prill 2031.
Bazuar në nenin 2, seksioni 2.02, pika 2. g, Huamarrësi do tã paguajë Bankës tarifën e angazhimit prej 0.5 % në vit, mbi totalin e shumës së disponueshme për çdo këst.
Huamarrësi do tã paguajë Bankës një komision fillim-mbarim të barabartë me 1 % (ose një shumë tjetër të tillë të specifikuar në marrëveshjen e kredisë) të shumës së principalit për çdo këst. Në seksionin 1.02 ñPërkufizimetò, paragraf 2, përcaktohet: ñ*Përfaqësues i autorizuar i huamarrësit do të thotë Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Huamarrësit*ò.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1.1. Marrëveshja e financimit të projektit me huadhënësin, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve.

1.1. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në miratimin e marrëveshjes së financimit.

Me ligjin nr. 125/2016, është ratifikuar marrëveshja ñPër ratifikimin e marrëveshjen e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropianë për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), në lidhje me marrëveshjen e Huas ndërmjet

Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Bankës Evropiane për Zhvillim (BERZH), për projektin ñShqipëria: Plani i strukturimit të KESHò.
Sipas kësaj marrëveshje, BERZH ka rënë dakord që tõ japë Huamarrësit një hua në vlerën deri 218 milionë Euro, në bazë të afateve dhe kushteve të parashtruara ose të referuara në marrëveshjen e huas, por vetëm me kusht që Garantuesi:
i. Të sigurojë mbështetjen e nevojshme, duke përfshirë sa i përket planit të reformës bashkëlidhur Marrëveshjes së Huas dhe planit të veprimit për qeverisjen e korporatës që do të miratohet në përputhje me planin e reformës.
ii. Të garantojë detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas, secila sipas parashikimit në këtë Marrëveshje.
iii. *Duke patur parasysh që* Garantuesi, duke marrë në konsideratë që Banka lidh Marrëveshjen e Huas me Huamarrësin, ka pranuar të garantojë këto detyrime të Huamarrësit dhe të kryejë dhe të marrë masa për kryerjen e detyrave të parashtruara në Planin e Reformës.
Në seksionin 1. 01. e, përcaktohet: ñNëse një dukuri e specifikuar në pikën 7.06, të afateve dhe kushteve standarde ka ndodhur dhe është në vazhdimësi, Banka mund të zgjedhë që tõ kërkojë Huamarrësit të paguajë interesa për pjesën e kredisë, nëse ka, që është subjekt i norme fikse interesi, jo më një normë fikse interesi, por në vend të saj, me një normë të ndryshme interesi.
Bazuar në nenin 2, seksioni 2.01, huaja përbëhet nga dy këste: Kësti A në shumën deri 118 milionë Euro dhe kësti B në shumën 100 milionë Euro.
Bazuar në nenin 2, seksioni 2.02.1, Huamarrësi do të shlyejë kredinë në 28 këste të barabarta gjashtëmujore (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) me 10 prill dhe 10 tetor të çdo viti, me datën e parë të shlyerjes së kredisë që do të jetë 10 tetor 2017 dhe me datën e fundit të shlyerjes së kredisë që do të jetë 10 Prill 2031.
Bazuar në nenin 2, seksioni 2.02, pika 2. g, Huamarrësi do tõ paguajë Bankës tarifën e angazhimit prej 0.5 % në vit, mbi totalin e shumës së disponueshme për çdo këst.
Huamarrësi do tõ paguajë Bankës një komision fillim-mbarim të barabartë me 1 % (ose një shumë tjetër të tillë të specifikuar në marrëveshjen e kredisë) të shumës së principalit për çdo këst.
Bazuar në seksionin 4.01 ñRegjistrat financiarë dhe raportimi i planit të reformësò, përcaktohet:
a. Huamarrësi do të realizojë procedurat, regjistrat dhe llogaritë në mënyrë të përshtatshme për të pasqyruar, në përputhje me standardet ndërkombëtare të miratuara të kontabilitetit në mënyrë të qëndrueshme, operacionet dhe kushtet e huamarrësit dhe degëve të tij, nëse ka dhe do të monitorojë dhe regjistrojë në mënyrë të përshtatshme ecurinë e projektit (duke përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që do të rrjedhin prej tij). Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, nuk është realizuar ndonjë procedurë për analizimin e kostos dhe përfitimit nga kjo hua. Pavarësisht impaktit të lartë që jep përdorimi i huas, mos menaxhimi i duhur ka bërë që implementimi i huas të bëhet me vonesë, pasojat e së cilës, trajtohen në një pikë tjetër të auditimit.
b. Huamarrësi do të:
Bazuar në seksionin 6. 01. b ñKushtet para hyrjes në fuqiò, Banka ka marrë një listë të projekteve të investimeve për modernizimin dhe përmirësimet që rezultojnë në rritje të mbrojtjes mjedisore dhe/ose përmirësimet e eficiencës së energjisë për një shumë të përgjithshme të barabartë me të paktën 10 milionë Euro, e cila do të zbatohet nga huamarrësi brenda 5 viteve nga nënshkrimi i marrëveshjes së huasë.

Bazuar në skedulin 1, për shumën 118 milionë Euro është parashikuar shlyerja e borxhit me disa banka, të cilat janë konsideruar me risk të lartë që në fazën e negocimit të marrëveshjes së financimit, të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 1

Kreditori	Monedha	Shuma	Maturimi i ardhshëm
Banka Intesa San Paolo	Lek	4,200,000,000	31.03.2017
Banka Intesa San Paolo	Lek	1,000,000,000	31.03.2017
Banka Raiffessen	Lek	4,980,000,000	30.09.2016
Banka Raiffessen	Lek	1,390,000,000	30.09.2016
Banka Raiffessen	Euro	16,000,000	30.09.2016
Banka Raiffessen	Euro	8,000,000	30.09.2016
Banka Raiffessen	Euro	9,000,000	30.09.2016
Banka Raiffessen	Lek	5,610,000,000	30.09.2016
Banka Raiffessen	Lek	4,900,000,000	30.09.2016
Banka Kombëtare Tregtare	Lek	1.500,000,000	23.12.2016
Banka Kombëtare Tregtare	Lek	1,600,000,000	23.12.2016
Societe Generale	Euro	6,000,000	28.02.2017

Burimi: Marrëveshja e financimit.

Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, deri në momentin e auditimit, likuidimi i parashikuar sipas tabelës së mësipërme nuk është realizuar në masën 100 %, për arsye mungesës së fondeve, ardhur kryesisht nga lëvizjet e kursit të këmbimit të Euro me Lekë, problematikë e cila trajtohet e detajuar në drejtim tjetër të auditimit.

Bazuar në skedulin 2, kategoritë, shuma e kredisë e shpërndarë sipas çdo kategorie dhe përqindja e financimit paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 2

Kategoria	Shuma e kredisë në (Euro)	Përqindja e financimit
(1) Rifinancim i kredive të përshkruara në skedulin 1 nga kësti A	116,820,000	100 %
(2) Rifinancimi i kredive të përshkruara në Skedulin 1 nga kësti B	99,000,000	100 %
(3) Komision fillim-mbarim i kështit A	1,180,000	100 %
(4) Komision fillim-mbarim i kështit B	1,000,000	100 %
TOTALI:	**218,000,000**	

Burimi: Marrëveshja e financimit.

Programi i BERZH për KESH SHA dhe ristrukturimin e sektorit Shqiptar të energjisë elektrike, paraqitet si më poshtë:

a. Kuadri Ligjor
b. Ristrukturimi i bilancit të KESH
c. Metodologjia e tarifimit
d. Drejtimi dhe struktura e korporatës
e. Tregtia/tregu rajonal
f. Struktura e korporatës së huamarrësit
g. Prodhimi i huamarrësit
h. Aftësia ripërtëritëse klimaterike
i. Rrjeti i sigurisë lokale
j. Bashkëfinancimi i kështit B

k. Treguesit e performancës së KESH

Marrëveshja e financimit është amenduar dy herë.
Amendamenti nr. 1, i Marrëveshjes së Huas ndërmjet KESH SHA dhe BERZH, është nënshkruar me datë 17.04.2018. Amendamenti ka të bëjë me ndryshimin e detyrimeve që kanë lidhje me Skedulin 3, pika (A) ñKuadri ligjorò nënpika 2. Kjo pikë ishte parashikuar ñ*Rishikimi i çmimeve të rregulluara për prodhimin e energjisë elektrike dhe çmimet e tregut të shitjes me shumicë në linjë me përfundimin e kontratës afatgjatë për furnizimin/blerjen e OSHEE/KESH, me të ardhura në nivelin e tarifës për KESH të konfirmuara me shkrim në mënyrë të pëlqyeshme për BERZH", e cila është ndryshuar "Detyrimi i shërbimit publik për vitin 2019 e në vazhdim dhe posaçërisht mekanizmi i vendosjes së çmimit për shitjen e energjisë elektrike midis KESH dhe OSHEE, do të ndryshohet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Energjisë Elektrike (Ligji nr. 43/2015) dhe traktatit të Komunitetit të Energjisë, jo më vonë se fundi i vitit 2018 dhe në një mënyrë të kënaqshme për BERZH".* Sa më sipër, realizimi i detyrimit të përcaktuar në marrëveshje për rishikimin e çmimeve të rregulluara nga dy institucionet KESH dhe OSHEE, është shtyrë në kohë dhe implementimi i parashikuar nuk do të bëhej më nga dy institucionet por në varësi të ndryshimeve që do i bëhen ligjit të energjisë elektrike.
Amendamenti nr. 2 i marrëveshjes së Huas ndërmjet KESH SHA dhe BERZH, është nënshkruar me datë 06.06.2018. Sipas këtij amendamenti, është fshirë seksioni 2.03.b me përcaktimin ñ*Tërheqjet që duhet të paguhen në llogarinë bankare të listuara në Skedulin 1 për llogaritë në Euro. Për llogaritë në vlera të tjera, shuma për t'u tërhequr në Euro do të miratohet nga Huamarrësi dhe llogaria bankare do t'i njoftohet Bankës*ò.

Pika 2.1.2. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në ngritjen e strukturave për funksionimin e marrëveshjes së financimit.

1. Titulli i gjetjes:	Nuk është ngritur strukturë për zbatimin, menaxhimin ose kordinimin e projektit.
Situata:	Në ligjin nr. 125/2016, është ratifikuar marrëveshja ñPër ratifikimin e marrëveshjen e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropianë për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), në lidhje me marrëveshjen e Huas ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Bankës Evropiane për Zhvillim (BERZH), për Projektin ñShqipëria: Plani i strukturimit të KESHò, ñHyrjeò, përcaktohet: ñ*Banka ka organizuar një bashkëpunim teknik për të organizuar një konsulent të jashtëm për të kryer një inspektim të boshllëqeve të drejtimit të korporatës te Huamarrësi dhe zhvillimin e një plani veprimi për të korrigjuar këto boshllëqe, në përputhje me hapat dhe afatin kohor të vendosur në seksionin e "Qeverisjes së Korporatës dhe Strukturës së Korporatës" të Planit të Reformës*ò. Në seksionin 1.02 ñPërkufizimetò, paragraf 2, përcaktohet: ñ*Përfaqësues i autorizuar i huamarrësit do të thotë Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Huamarrësit*ò. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, në lidhje me menaxhimin e projektit, organizimi është bërë sipas departamenteve përkatëse dhe jo nga një

	organ i krijuar i cili të mbulojë të gjitha fushat e përfshira në zbatimin e projektit. Po ashtu, nuk është krijuar një njësi, e cila do të zbatonte, menaxhonte apo koordinonte aktivitetin e projektit, duke patur parasysh se në zbatimin e programit për mundësimin e huas, janë të përfshirë edhe institucione të tjerë si Enti Rregullator i Energjisë dhe OSHEE. Në marrëveshjen e huas nuk ka patur përcaktime në lidhje me mënyrën e menaxhimit, përveç përcaktimit të Seksionit 1.02.
Kriteri:	Seksionin 1.02 i marrëveshjes, ñPërkufizimetò, paragraf 2
Ndikimi/Efekti:	Nuk është bërë koordinimi i duhur ndërmjet institucioneve për realizimin e detyrimeve të përcaktuar në marrëveshje për bërjen efektive të huas në periudhën e parashikuar, pasojë e të cilave është rritur kosto e projektit, si për pagesa interesash, ashtu dhe për pagesë të tarifës së angazhimit.
Shkaku:	Mos organizimi i duhur për përfshirjen e institucioneve të ngarkuara me zbatimin e marrëveshjes.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	KESH SHA të marrë masa për ngritjen e strukturave të menaxhimit për projektet në vazhdimësi, me synim zbatimin me korrektësi të përcaktimeve në marrëveshjet me huadhënësin, me cilësinë dhe afatin e parashikuar.

2. Titulli i gjetjes:	**Nuk është zhvilluar analizimi kosto-përfitim.**
Situata:	Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, nuk është realizuar ndonjë procedurë për analizimin e kostos dhe përfitimit nga huaja.
Kriteri:	Marrëveshja e financimit, Seksionin 4.01.a
Ndikimi/Efekti:	Pavarësisht impaktit të lartë që jep përdorimi i huas, mos menaxhimi i duhur ka shkaktuar vonesa të cilat kanë sjellë pasoja në shlyerjen në kohë të overdrafteve, me pasojë mos arritje të objektivit të parashikuar si dhe pagesa për tarifa të angazhimit, të cilat në mënyrë të detajuar, paraqiten në drejtim tjetër të auditimit.
Shkaku:	Mos zbatim i përcaktimeve në marrëveshje.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Rekomandimi: KESH SHA të marrë masa për analizimin e kostos dhe përfitimeve nga marrja e huas dhe shlyerja e overdrafteve të përcaktuara. Të nxirren përgjegjësitë për vonesat e shkaktuara.

Për sa më sipër mban përgjegjësi z. A. H., në cilësinë e Ish-Administratorit të KESH.
Sa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr. 1, datë 30.10.2020.

2.2. Mbi mënyrën e përzgjedhjes së overdrafteve për shlyerje, radha e ndjekur, stadin e tyre në momentin e likuidimit.

1-Nga auditimi u identifikuan **1.266 milion euro efekt financiarë negativ** si shpenzime për tarifën e angazhimit të bankës për mos tërheqjen në kohë të kredisë nga Kredi marrësi. Mos tërheqja në kohë e kredisë nga KESH SHA ka ardhur si rezultati i mos plotësimit të kushteve të vendosura nga banka që kanë të bëjnë me palë të treta, si KM, Ministria e Energjetikës, ERE etj, për mos miratimin në kohë të ligjeve dhe akteve ligjore sipas marrëveshjes.

2-Nga auditimi u identifikuan **548,277,597 lekë efekt financiarë negativ** si pagesa të interesave të overdrafteve që KESH SHA kishte për efekt mbyllje por që u mbyllën me vonesë pas tërheqjes së fondeve të kredituar, pas plotësimit të kushteve të pikës 1 të cilat janë në lidhje direkte dhe indirekte me KESH SHA.
3-Nga auditimi u identifikuan **102,599 euro shpenzime të rikuperueshme,** të mbajtura më tepër nga kredidhënësi si rezultat i mos rakordimit të plotë të shumës së lëvruar, me mundësi rikuperimi në periudhat në vazhdim.

2.2.1. Kriteret e vendosura për shlyerjen e kredive të mëparshme të KESH SHA.
2.2.2. Përcaktimi i radhës së shlyerjes së kredive.
2.2.3. Mbi plotësimin e detyrimeve nga ana KESH SHA, sipas përcaktimeve në marrëveshje.
2.2.4. Mbi procesin e negocimit me bankat e nivelit të dytë për mundësinë e strukturimit të borxhit sipas termave të marrëveshjes me BERZH.

Nga auditimi konstatohet:

Pika 2.2.1. Kriteret e vendosura për shlyerjen e kredive të mëparshme të KESH SHA.
Marrëveshja e Huas së EBRD të ratifikuar me Ligjin Nr. 125/2016 "Për projektin "Shqipëria: Plani i Ristrukturimit të KESH-it" ka për subjekt rifinancimin e borxhit afatshkurtër (portofoli i OD) të mbështetur me Garanci Qeveritare.
Më datën 20 Prill 2018, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në përputhje me Paragrafin 9.01 të Kushteve dhe Termave Standarde të Marrëveshjes së Huas dhe Marrëveshjes së Garancisë të ratifikuar me Ligjin Nr.125/2016 ñPër projektin "Shqipëria: plani i ristrukturimit të KESH-itò, ka njoftuar KESH SHA për bërjen efektive të kredisë së dhënë sipas kësaj marrëveshje, duke filluar që prej datës së marrjes së njoftimit, pra rreth 20 muaj mbas ratifikimit të marrëveshjes në Parlament ose 16 muaj pas miratimit me dekret të presidentit nr. 9931 datë 30.12.2016.
Kjo vonesë prej 16 muajsh ka ardhur kryesisht nga mos miratimi në kohë të kushteve të vendosura sipas Paragrafit 9.01 të Kushteve dhe Termave Standarde të Marrëveshjes së Huas dhe Marrëveshjes së Garancisë të ratifikuar me Ligjin Nr.125/2016 ñPër projektin "Shqipëria: plani i ristrukturimit të KESH-itò por është dashur ndërhyrja e bankës EBRD me amendamentin nr. 1 datë 17.04.2018 për pranimin e kushteve në fazën që janë. Kjo vonesë kryesisht ka ardhur nga: Mos miratimi nga MIE i akteve të plota nënligjore të operimit të ligjit të sektorit të energjisë, Nga mos pranimi dhe miratimi i rritjes së tarifës së shitjes së energjisë nga KESH në OSHE nga ana e ERE-s, Nga mos pranimi dhe rakordimi i detyrimeve të ndërsjella KESH-OST-OSHEE etj.
Sipas parashikimeve të marrëveshjes së mësipërme, paragrafit 2.02 (9) të saj, me bërjen efektive të marrëveshjes, duhet të fillojë procesi i disbursimit të transhit të parë prej 118 milion EUR (rreth 116.8 milion EUR efektive për mbyllje linjash OD **pas pagesës së komisioneve dhe tarifave që lidhen me angazhimin dhe disburismin e fondeve hua).**
Struktura e portofolit OD me Garanci Qeveritare subjekt rifinancimi nga huaja e EBRD është:
- Nga pikëpamja e monedhës: linja OD në monedhën vendase (Lekë) në një total prej rreth 25,18 miliardë Lekë (rreth 74% e totalit) dhe linja OD në monedhën të huaj (Euro) rreth 39 milionë Euro (apo rreth 15%).
- Sipas shpërndarjes nëpër banka të nivelit të dytë: rreth 62% e portofolit të linjave OD janë pranë Raiffeisen Bank, 15% pranë Intesa Sanpaolo, rreth 10% pranë BKT dhe rreth 3% pranë Societe General Bank.

Tabela nr. 3

Linjat e Kredive dhe OD-ve	Miratimi	Limiti OD	Norma interesit	Komision Rinovimi	Penaliteti në Vonesë	Afati
Intesa SanPaolo	Garanci Qeveritare	4,200,000,000 Lekë	3%	0.3%	3%	31-Mar-19
	Garanci Qeveritare	1,000,000,000 Lekë	3%	0.3%	3%	31-Mar-19
OD Raiffeisen Bank	Garanci Qeveritare	4,980,000,000 Lekë	Bono Thesari 1vjeçare+0.7%(min 3.91%)	0.1%	3%	30-Sep-18
	Garanci Qeveritare	1,390,000,000 Lekë	Bono Thesari 1vjeçare+0.7%(min 3.91%)	0.1%	3%	30-Sep-18
	Garanci Qeveritare	5,610,000,000 Lekë	Bono Thesari 1vjeçare+0.7%(min 3.91%)	0.1%	3%	30-Sep-18
	Garanci Qeveritare	1,081,047,000 Lekë	Bono Thesari 1vjeçare+0.7%(min 3.91%)	0.1%	3%	30-Sep-18
	Garanci Qeveritare	3,577,500,000 Lekë	Bono Thesari 1vjeçare+0.7%(min 3.91%)	0.1%	3%	30-Sep-18
	Garanci Qeveritare	33,000,000 ú	Euribor 1 vje: ar+2.3%	0.3%	3%	30-Sep-18
CL - Banka Kombëtare Tregtare	Garanci Qeveritare	1,500,000,000 Lekë	Bono Thesari 12 mujore+1%	0.0%	4%	21-Dec-18
	Garanci Qeveritare	1,600,000,000 Lekë	Bono Thesari 12 mujore+1%	0.0%	4%	21-Dec-18
OD – Societe Generale	Garanci Qeveritare	6,000,000 ú	2.30%	0.0%	2.50%	28-Feb-19
TOTALI I OD me GQ sipas monedhave	**ALL**	**24,938,547,000 Lekë**				
	EUR	**39,000,000 €**				
TOTALI I OD me GQ	**Konvertuar në LEKË**	**29,863,467,000 Lek**				
	Konvertuar në EUR	**236,486,118 €**				

Burimi: KESH SHA

Me bërjen efektive të huasë dhe duke parë kompleksitetin e karakteristikave të portofolit të OD-ve subjekt rifinancimi, shoqëria KESH paraqet tek EBRD aplikimin për disbursimin e transhit të parë sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë dhe si rrjedhojë del e nevojshme që shoqëria të vlerësojë dhe administrojë risqet e mundshme që shoqërojnë procesin/kryerjen e këtij operacioni financiar.

1) Cilat linja OD do të synohen për tu mbyllur me këstin e parë,
2) Si mund të administrohet impakti që sjell hedhja në tregun valutor vendas e një sasie të madhe valute;
3) Si mund të administrohet risku i KESH nga luhatja e kursit të këmbimit;
4) Si mund të ruhet vijueshmëria e marrëdhënies së KESH me bankat e nivelit të dytë bazuar në historikun e performancës financiare të veprimtarisë operacionale të KESH me këto banka;

Pas vlerësimit të zhvillimeve aktuale dhe të tashme të tregut valutor, veprimtaria e KESH për administrimin e risqeve të mundshme që shoqërojnë procesin/kryerjen e këtij operacioni financiar konsiston si më poshtë:

1) Linja OD që do të synohen për tu mbyllur me transhin e parë: portofoli i OD-ve që është subjekt rifinancimi me huanë e EBRD konsiston në linja OD në monedhën EUR (me normë interesi 2.3%) dhe linja OD në monedhën Lekë me norma interesi që variojnë nga 3% (linjat me Bankën Intesa Sanpaolo) në 3.68% linjat me BKT dhe 3.91% linjat me Raiffeissen Bank. *Në kushtet kur Euro është zhvlerësuar kundrejt lekut, normat e interesit të OD në Euro janë më të ulëta, kosto e shërbimit të borxhit në Euro është më e lirë se ajo e OD në Lekë, është e këshillueshme që me qëllim minimizimin e riskut që buron nga normat e interesit dhe uljen e shpenzimeve të pagueshme për interesa OD**, **të mbyllen fillimisht OD në LEK duke filluar nga ato linja OD me normë interesi më të lartë.***

2) Administrimi i impaktit që mund sjellë kësti i parë në tregun valutor vendas: Sipas marrëveshjes së huas, me plotësimin e kushteve për bërjen efektive të saj do të lëvrohet kësti i parë prej 116.8 milion EUR.
Për kushtet aktuale të tregut valutor, kjo shumë është relativisht e madhe dhe për pasojë ndikimi që ka hedhja e këtij volumi valutor EUR në tregun vendas pritet të jetë i lartë. Po sipas marrëveshjes së huas KESH-EBRD, ky këst mund të lëvrohet në dy forma:
a) Lëvrim i kështit në një transaksion të vetëm: Për karakteristikat e tregut tonë bankar, është operacionalisht pothuajse e pamundur që tregu bankar vendas (tre banka) të përthithin një sasi Euro në vlerën rreth 116,82 milionë Euro në mënyrë të menjëhershme pasi lëvrimit të kështit me një transaksion të vetëm do ta çonte tregun bankar drejt një shok-u valuator, çka do të sjell pasoja të pashmangshme në tregues të ndryshëm financiar duke zhvlerësuar në mënyrë të menjëhershme dhe artificiale Euron në raport me monedhën vendase. Pasoja e këtij transaksioni në ekonominë shqiptare në tërësi janë të vështira për tu përllogaritur por gjithësisë janë shumë më të larta se "mbrojtja" që mund të sigurojë KESH nga kursi i këmbimit.

1. Titulli i gjetjes:	Efekte financiare nga mostërheqja në kohë e kredisë
Situata:	KESH SHA nuk ka përllogaritur humbjen që i shkaktohet nga tarifa e angazhimit për të cilën KESH sha ka paguar shumën prej **1,066,455.10 Euro pas lëvrimit të tranzhit A**. Për rrjedhojë, për tranzhin A janë rritur kostot me tarifën e angazhimit si rezultati i tërheqjes me vonesë të shumës së akorduar me 1,066,455.10 euro. Kjo ka ndodhur si rezultat i mos plotësimit të kushteve të vëna nga banka, kryesisht të kushteve të tregut energjetik për tu plotësuar nga ERE, rakordimin me detyrimet që OSHEE ka ndaj KESH, rritjen e çmimit të shitjes së energjisë nga KESH sha e cila miratohet nga ERE, etj. Për tranzhin B KESH SHA ju kanë rritur kostot me tarifën e angazhimit si rezultati i tërheqjes me vonesë prej 72 ditësh sipas shkresës nr. 1034 datë 03.04.2020 të EBRD me **100,000 euro (**100,000,000 euro x (72/360 x 0.5%) = 100,000 euro.**)**
Kriteri:	Situata është në kundërshtim me Nenin 2 Afatet Kryesore të huasë Seksionin 2.02 Afate të tjera Financiare të kredisë pika *g) Huamarrësi do ti paguajë Bankës tarifën e angazhimit prej 0.5% në vit mbi totalin e shumës së disponueshme për çdo këst*. Tarifa e angazhimit për Kështin A do të mblidhet që nga data gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së Marrëveshjes të Kredisë dhe Tarifa e angazhimit për Kështin B do të mblidhet që nga data gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës në të cilën Banka konfirmon me shkrim disponueshmërinë e Kështit B dhe do të mblidhet dhe llogaritet në të njëjtën bazë të interesit sipas Seksionit 3.04 (b)(ii)
Ndikimi/Efekti:	Krijimi i kostove shtesë në vlerën **1,166,455.10 Euro**
Shkaku:	Mosplotësimi i kushteve të vendosura në marrëveshjen e ratifikuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	KESH SHA të marrë masa për angazhim maksimal në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave apo kushteve të përcaktuar si dhe te nxisë organet e tjera për plotësimin e detyrimeve të tyre të adresuara nga zbatimi i marrëveshjes, me qëllim respektimin e afateve dhe mënjanimin e kostove shtesë në këtë projekt të cilat kanë krijuar efekt financiar negativ në vlerën **1,166,455 Euro**.

2. Titulli i gjetjes:	Mungesë rakordimi mbi komisionet e pagueshme të disbursimit.
Situata:	Për tranzhin B është mbajtur më tepër komision fillim-mbarim prej 1%. Nga ana e huamarrësit KESH SHA janë përdorur vetëm 89,740,094 euro nga Tranzhi B në total prej 100,000,000 euro, pasi për diferencën prej 10,259,906 euro KESH SHA ka negociuar me Intesa Sanpaolo Bank duke e strukturuar OD sipas kushteve të marrëveshjes me BERZH. Komisioni fillim mbarim që BERZH duhet të mbante nga TRANZHI B është 89,740,094 euro x 1% = 897,401 euro pra ka mbajtur **102,599 Euro më tepër** (si diferencë mes 1%*100,000,000 ï 1%*89,740,094)
Kriteri:	Situata është në kundërshtim me Nenin 2 Afatet Kryesore të huasë Seksionin 2.02 Afate të tjera Financiare të kredisë pika h) huamarrësi do ti paguajë bankës një komision fillim-mbarim të barabartë me një përqind (1%) të shumës së principalit për çdo këst. Për këstin A, ai do të paguhet pas përmbushjes së Kushteve për Hyrjen në Fuqi sipas Afateve dhe Kushteve Standarde: për Këstin B, ai do të paguhet pas përmbushjes së kushteve të vendosura në njoftimin me shkrim për Huamarrësin, i cili është referuar në pikën 2.01(c)
Ndikimi/Efekti:	Krijimi i kostove shtesë në vlerën **102,599 Euro**
Shkaku:	Mungesë rakordimi i shumave të lëvruara dhe tarifës së mbajtur për to.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	KESH SHA të marrë masat e nevojshme me Huadhënësin për rakordimin e shumave të mbajtura për komisionet e huasë, fillim-mbarim, dhe rikuperimin e vlerës prej **102,599 Euro** gjatë pagesave në vijim duke kryer dhe sistemimet përkatëse.

3. Titulli i gjetjes:	Vonesa në mbylljen e overdrafteve me efekte financiare.
Situata:	Me miratimin e ligjit Nr. 125/2016 "Për projektin "Shqipëria: Plani i Ristrukturimit të KESH-it" dhënia e një huaje prej 218,000,000 Euro, KESH SHA për tërheqjen e shumës së bashku me institucionet e tjera, OSHEE SHA, OST SHA, ERE apo MIE duhet të plotësojnë kushtet e vendosura nga banka, si njohja e detyrimeve mes palëve, hartimi i kuadrit të plotë ligjore, rritje e çmimit të shitjes së energjisë nga KESH etj. Nga mosplotësimi i këtyre kushteve në një afat kohorë prej 60 ditësh, me qellim shmangien e penaliteteve, kjo kredi është bërë e mundur të tërhiqet vetëm në prill 2018. Nga mos plotësimi i kushteve në kohë nga institucionet e renditura më sipër, KESH sha për vitin 2017 ka paguar **548,277,597 lekë interesa overdraftesh si rezultat i mos tërheqjes dhe pagesës së tyre me huanë e miratuar, vlerë e cila përbën efekt financiar negative për shoqërinë.**

Kriteri:	Situata është në kundërshtim me Nenin 2 Seksioni 2.03 Detyrimi për mbështetjen e Projektit a) Kryerja (në lidhje me vetveten) dhe marrja e masave për kryerjen (në lidhje me Huamarrësin dhe me çdo agjenci ose autoritet përkatës shtetëror apo çdo nënndarje përkatëse të tyre ose çdo subjekt në pronësi dhe i kontrolluar prej tyre ose që vepron për llogari ose përfitim të Garantuesit): 1. Secila nga detyrat e parashtruara në Planin e Reformës në datën përkatëse të përcaktuar në të; dhe 2. Nga data në të cilën CGAP miratohet nga Banka dhe nga Huamarrësi, secila nga detyrat e parashtruara në CGAP në datën përkatëse të përcaktuar në të. b) Të sigurojë që Huamarrësi është në përputhje me secilin nga detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Huas; c) Të ndihmojë, në përputhje me ligjet e Shqipërisë, që rregullimet e nevojshme të tarifës së energjisë elektrike të miratohen për të garantuar që aplikimet e tarifës së Huamarrësit në mënyrën e përcaktuar në Planin e Reformës do të përmbushen në përputhje me metodologjinë e miratuar dhe të parashtruar në Planin e Reformës; d) Të sigurojë që asnjë veprim, i cili do të parandalonte ose ndërhynte në: i) zbatimin e Projektit; ose ii) përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit në lidhje me Projektin, nuk është marrë ose lejuar të merret qoftë nga Garantuesi ose nga çfarëdo agjencie ose autoriteti përkatës shtetëror apo çdo nënndarje përkatëse të tyre ose çdo subjekt në pronësi dhe i kontrolluar prej tyre ose që vepron për llogari ose përfitim të cilësdo prej tyre; e) Të sigurojë mbledhjen nga Huamarrësi sipas Planit të Reformës, në bazë të Treguesve të Performancës së KESH-it të parashtruar në Planin e Reformës; dhe f) Të bashkëpunojë me çdo konsulent të angazhuar sipas emërimeve TC, për të garantuar që mund të përmbushë kriteret e tij sipas kontratës
Ndikimi/Efekti:	Interesa overdraftesh si rezultat i mos tërheqjes dhe pagesës së tyre me huanë e miratuar në vlerën **548,277,597 lekë.**
Shkaku:	Mbyllja me vonesë e overdafteve të mëparshme.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	KESH SHA në të gjitha rastet të tregojë angazhim maksimal në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave apo kushteve të përcaktuara në marrëveshje si dhe te nxisë organet e tjera për plotësimin e tyre sipas rastit, me qëllim respektimin e afateve të miratuara për mënjanimin e kostove shtesë në këtë projekt të cilat deri në këtë fazë arrijnë vlerën **548,277,597 lekë**.

Pika 2.2.2 Përcaktimi i rradhës së shlyerjes së kredive.

Nga ana e këshillit mbikëqyrës është marrë vendimi nr. 8 datë 26.04.2018 për ñPlani i veprimeve të KESH Sha për administrimin e risqeve të veprimtarisë së saj operacionale për zbatimin e marrëveshjes së huas me BERZHò

1. Të zbatojë për sa të jetë e mundur rekomandimet e Bankës së Shqipërisë dhe/apo Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nëse do të ketë të tilla në përgjigje të njoftimit të KESH SHA.
2. Kësti i parë të lëvrohet në disa transaksione **(minimalisht 20 mln € referuar kontratës midis KESH dhe BERZH, Neni 2, Seksioni 2.02)** në intervale kohore të caktuara (minimalisht dy javë) për të minimizuar impaktin që mund të sjellë hedhja në tregun valutor vendas (zhvlerësim të menjëhershme dhe artificial të Euro në raport me monedhën vendase) dhe pasojat negative në ekonominë Shqiptare në tërësi.
3. Të mbyllen linjat OD në lekë që KESH ka në 3 banka (Banka Kombetare Tregtare, Raiffeisen Bank dhe Intesa Sanpaolo Bank) **duke filluar nga linjat e OD me normat më të larta të interesit.**
4. Të dokumentohet çdo ditë informacioni zyrtar i kursit të këmbimit (Euro/Lek) të publikuar nga bankat e nivelit të dytë ku do të mbyllen linjat e overdrafteve me qëllim përllogaritjen paraprake të shumave në EUR që do të disbursohen për mbylljen e linjave të OD në lekë në bankat përkatëse.

Pika 2.2.3 Mbi plotësimin e detyrave nga ana e KESH SHA, sipas përcaktimeve në marrëveshje.

Tabela nr. 4

DETYRA	**PROGRAMI KOHOR/DATAT**	**ENTI I NGARKUAR**
(A) Kuadri Ligjor Garantuesi do të: Miratojë Rregullat e Tregut në lidhje me prodhimin dhe aktivitetet e shitjes me shumicë dhe Rregullat e tjera të Tregut me ndikim në KESH, në përputhje me Nenin 19 dhe 98, Ligji për Sektorin Energjetik (PSL), duke përfshirë Rregullat që nxisin Hapjen/ Konkurrencën e Tregut në përputhje me nenin 8(1) PSL, duke u bazuar në nenin 97 PSL.	CP deri në Hyrjen në Fuqi	Neni 19, Përgjegjësitë e ERE-s Neni 98 Rregullat e tregut, miratohen nga ERE Neni 99 Përgjegjësia e balancimit të pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, qe miratohen nga ERE Aktet e mësipërme janë miratuar nga ERE nëpërmjet Vendimeve vijuese Rregullat e Përkohshme te Tregut Vendim Nr. 139, date 15.08.2016. Rregullat e tregut, Vendim Nr. 214/2017. Hyjnë në fuqi në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të Energjisë, akoma nuk është ne fuqi.
Rishikojë çmimet e rregulluara për prodhimin e energjisë elektrike dhe çmimet e tregut të shitjes me shumicë në linjë me përfundimin e kontratës afatgjatë për furnizimin/blerjen e OSHEE/KESH-it, me të ardhura në nivelet e tarifës për KESH-in të konfirmuara me shkrim në mënyrë të pëlqyeshme për EBRD-në.	CP deri në Hyrjen në Fuqi	Akti nënligjor rregullues vijon te jete VKM Nr. 244/2016 i cili Krijon modelin e përkohshëm te Tregut te energjisë. Modeli i Tregut sipas VKM 519/2016 akoma nuk është ne fuqi

Publikojë të gjitha të dhënat përkatëse të prodhimit në përputhje me Rregulloren e Komisionit të BE-së nr. 543/2013 të datës 14 qershor 2013.	CP deri në Hyrjen në Fuqi	Nr. 118, Datë 27.07.2017 Mbi miratimin e rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike.
Veprojë në Përputhje me Direktivën 2009/73/EC dhe rregulloren (KE) 715/2009.	Për livrimin e Transhit B	Për rregullat e tregut te gazit
Sigurojë që OSHEE të ndajë shpërndarjen nga furnizimi, për të siguruar përputhjen me Nenet 26 dhe 31 të Direktivës 2009/72/KE dhe Nenit 35 të PSL	Deri në fund të vitit 2017	Aksionari i shoqërisë OSHEE. Republika e Shqipërisë, ERE Ndarja e llogarive te shoqërive te sektorit e pa realizuar deri me 01.01.2020
Heqë rregullimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e tensionit të mesëm.	Deri në fund të vitit 2017	OSHEE, ERE. E realizuar edhe aktualisht pjesërisht
(B) Ristrukturimi i Bilancit të KESH-it Ristrukturimi dhe Heqja e Borxheve që nuk janë të KESH- it: Të gjitha borxhet në bilancin e KESH-it, të cilat nuk kanë lidhje me KESH-in (por, p.sh. janë për OSHEE-në ose për OST-në apo për ndonjë subjekt tjetër të tillë, i cili nuk është degë ose filial i KESH-it): (i) do të hiqen nga KESH-i dhe KESH-i nuk do të jetë më detyrues në lidhje me këto borxhe ose (ii) do të jetë subjekt i një rregullimi të pëlqyeshëm për Bankën ndërkohë që KESH-i mbetet detyruesi ligjor por është plotësisht i dëmshpërblyer në lidhje me të gjitha principalet, interesat, tarifat, kostot dhe shpenzime të tjera që krijohen në lidhje me to dhe rrjedhimisht nuk do të bëjë pagesa për shërbimet e borxheve nga fluksi i tij monetar në asnjë rrethanë (p.sh. shërbimet e borxhit do të jenë nga rregullimet me OSHEE-në dhe OST-në me mbështetje tjetër sipas nevojës).	CP deri në Hyrjen në Fuqi	KESH, OSHEE, OST Aksionari, Ministria e Financave. I pa realizuar plotësisht. U plotësua si kusht me amendamentin Nr. 1 te kontratës. Shërbimi i Borxhit Vijon për huatë e transferuara ne shoqëritë e sektorit.
Arkëtimet me vonesë nga subjektet shtetërore dhe arkëtimet e tjera financiare me vonesë do të shprehen në para ose do të fshihen me pagesat e KESH-it ndaj Subjekteve Shtetërore ose Qeverisë së Shqipërisë	Per livrimin e Transhit B	Për rakordimin e detyrimeve reciproke mes tatimeve KESH dhe OSHEE. I pa realizuar edhe pse ndërmarre veprime nëpërmjet Urdhrave te Kryeministrit Nr. 71 dhe 17

(C) Metodologjia e Tarifimit Agjencia Rregullatore e Energjisë (ERE) do të realizojë një rishikim gjithëpërfshirës të strukturës së tarifave për subjektet e sektorit, për tëi lidhur me strukturën e re të tregut dhe të përmbajë parimet për vendosjen e çmimeve jo diskriminuese dhe që pasqyrojnë koston.	Tremujori 4 i vitit 2016 dhe në vazhdim më pas sipas metodologjisë së miratuar	ERE. Tarifat per KESH vijojnë te **mbeten ne rendin e 1.5 leke**. Sipas përcaktimeve te VKm nr. 244
ERE-ja do të përgatitë një metodologji duke përfshirë një metodologji shumëvjeçare për tarifat e rrjetit dhe do tëi japë një kopje Bankës.	Tremujori 2 i vitit 2017	Miratuar me Vendim Nr. 182, date 10.11.2017 te ERE
Rregullorja e re shumëvjeçare për tarifat do të miratohet dhe zbatohet nga ERE.	Për livrimin e Transhit B	Nuk aplikohet përveçse per tarifa transmetimi dhe te operatorit te shpërndarjes
(D) Drejtimi i Korporatës dhe Struktura e Korporatës Plani i Veprimit për Drejtimin e Korporatës (ñCGAPò) do të miratohet ndërmjet BERZH-it, KESH-it dhe Garantuesit.	CP deri në Hyrjen në Fuqi	KESH, MIE Leter Konfirmimi CGAP, date 23.05.2017
KESH-i dhe Garantuesi do të zbatojnë të gjitha detyrat e përcaktuara në CGAP sipas afateve kohore të përcaktuara në GCAP (ose në një datë tjetër të mëvonshme sipas miratimit të BERZH-it).	Gjatë gjithë kohës.	KESH dhe MIE Sipas CGAP
KESH-i do të ndajë më BERZH-in dhe me Konsulentët e BERZH-it të gjithë informacionin e kërkuar për Drejtimin e Korporatës me Kujdesin e Duhur, duke përfshirë por pa u kufizuar tek aktet nënligjore, politikat e brendshme dhe procedurat, dokumentet/raportet përkatëse të kaluara që komentojnë çështjet e drejtimit të korporatës dhe çdo dokument tjetër i cili mund të jetë i dobishëm për drejtimin e korporatës me kujdesin e duhur (ñRaportetò).	Gjatë gjithë kohës.	KESH dhe MIE Sipas CGAP

Konsulentët e BERZH-it do të shqyrtojnë Raportet për të identifikuar boshllëqet me praktikat më të mira të Drejtimit të Korporatës. Konsulentët e BERZH-it do të kryejnë gjithashtu një shqyrtim të drejtimit të korporatës dhe do të bëjnë rekomandimet që Garantuesi dhe KESH-i mund të përdorin për të vendosur ose përmirësuar politikat në të gjitha fushat e nevojshme, veçanërisht për kompensimin, rekrutimin, emërimet, planifikimin dhe prokurimet; konsulentët do të përgatisin rekomandimet e detajuara me rishikimin e matricave me kolegët përkatës.	Gjatë gjithë kohës.	KESH dhe MIE Sipas CGAP
Finalizimi i drejtimit të korporatës dhe plani i ristrukturimit do të diskutohen dhe miratohen ndërmjet Garantuesit, KESH-it dhe BERZH-it, me zbatimin e etapave për çdo pikësynim.	CP deri në Hyrjen në Fuqi	KESH, MIE Letër Konfirmimi CGAP, date 23.05.2017
Finalizimi i zbatimit të drejtimit të miratuar të korporatës, plani i ristrukturimit dhe reforma ligjore.	Tremujori 4 i vitit 2017 dhe Afati i Këstit B	KESH, MIE Letër Konfirmimi CGAP, date 23.05.2017 Realizuar nëpërmjet raportimeve për zbatimin e CGAP
Dorëzohet tek BERZH-i për miratim një plan masash, që do ta sjellin në një investitor të pakicave, në formën dhe përmbajtjen e pranueshme nga BERZH-i	Për livrimin e Transhit B	MIE, Republika e Shqipërisë, KESH E pa realizuar
(E) Tregtia/Tregu Rajonal: Garantuesi dhe KESH-i, sipas rastit, do të: krijojnë një treg kombëtar të energjisë të organizuar dhe shkëmbim lokal të energjisë, krijojnë një treg kombëtar të energjisë të organizuar dhe shkëmbim lokal të energjisë, rishikojë kodet e energjisë elektrike, standardet dhe dokumentacionin përkatës për të lejuar funksionimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike. lejojë plotësisht tregtinë me instrumentet financiarë duke përfshirë të ardhmen dhe opsionet, si dhe të lejojë kontratat e mbrojtjes dhe të shkëmbimit të energjisë elektrike në treg.	Tremujori 1 i vitit 2018 Tremujori 1 i vitit 2018 Afati i Këstit B Tremujori 1 i vitit 2018	KM, MIE, ERE, krijimi i bursës KM, MIE, ERE ERE

Përgatitja e udhëzuesit për lidhjen e tregut shqiptar me tregun e Kosovës dhe mundësia e integrimit të mëtejshëm me tregjet rajonale në planin afatmesëm.	Për livrimin e Transhit B	Krijimi i Bursës ERE, MIE, MFE
F) Struktura e Korporatës së Huamarrësit Hiqet nga KESH-i detyrimi ligjor dhe operacional për të vepruar si Furnizues me Shumicë i Publikut ose për të blerë nga importi në emër të tregut shqiptar të energjisë.	CP deri në Hyrjen në Fuqi	Realizuar, **Korrik 2016.** Vendosur detyrimi për Shërbim Publik sipas VKM Nr. 244/2016 e ndryshuar
Hiqet nga KESH-i detyrimi ligjor dhe operacional për të qenë pala blerëse në Kontratat PPA të prodhuesve privatë të energjisë (d.m.th. PPA-të do të rinovohen ose në të kundërt do të transferohen ligjërisht jashtë KESH-it).	CP deri në Hyrjen në Fuqi	Realizuar **Korrik 2016** sipas VKm nr. 244/2016
(G) Prodhimi i Huamarrësit		
(G) Prodhimi i Huamarrësit Garantuesi dhe KESH-i do të përgatiten dhe do të përshtatin strategjinë dhe udhëzuesin për TPP Vlora, që të vendoset në funksionim në Tremujorin e parë të vitit 2018.	Për livrimin e Transhit B	MIE, procedura Koncesionare pa rezultat
H) Aftësia Ripërtëritëse Klimaterike Huamarrësi dhe Banka të bien dakord për Termat e Referencës për konsulentët, të cilët do të ndihmojnë Huamarrësin dhe Garantuesin që të ndërtojnë kapacitetin për menaxhimin e riskut klimaterik, duke përfshirë sigurimin hidrologjik (ñKonsulenti i Aftësisë Ripërtëritëse Klimaterikeò). Tenderimi për Konsulentin e Aftësisë Ripërtëritëse Klimaterike është përfunduar Plani i zbutjes së Riskut Klimaterik është miratuar nga Garantuesi, Huamarrësi dhe është zbatuar	CP deri në Hyrjen në Fuqi Tremujori 4 i vitit 2016 Tremujori 4 i vitit 2017	KESH. Permbushur **fillim viti 2017**. Plani per menaxhimin e rikut klimaterik, miratuat Dhjetor 2018 KESH, BERZH. Realizuar KESH, BERZH realizuar

(I) Rrjeti i Sigurisë Sociale Garantuesi do të: 1) përcaktojë konsumatorët në nevojë, në përputhje me kërkesat sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë; 2) kryejë analiza për identifikimin e mundësive të përmirësimit të masave të mbrojtjes sociale për të garantuar mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë ndaj rritjes së tarifave, duke përfshirë një analizë të ndikimit të tërthortë; 3) rishikojë mekanizma alternativë për zbatimin e programeve të asistencës sociale dhe të rekomandimeve; dhe 4) përgatisë rekomandime të qarta të bazuara në analizat e forcimit të sistemit të mbrojtjes sociale 5) përshtatë rekomandimet e analizës së mbrojtjes sociale.	Tremujori 2 i vitit 2017 Tremujori 2 i vitit 2017 Tremujori 2 i vitit 2017 Tremujori 2 i vitit 2017 Per livrimin e Transhit B	ERE, MFE, MIE, KM. Realizuar pjesërisht. Ka vijuar mbulimi i konsumatorëve me tarife energjie te rregulluar.
(J) Bashkëfinancimi i Këstit B Garantuesi do të realizojë një rishikim të tregut për të rishikuar dëshirën për të krediturar KESH-in. Pas një periudhe të pranueshme kohore të lejuar për rezultate të qarta nga reformat dhe ristrukturimi i parashikuar sipas Projektit, Garantuesi, KESH-i dhe BERZH-i do të formojnë një grup pune për të rishikuar dëshirën e tregut për të krediturar KESH-in. Nëse ekziston dëshira për të dhënë kredi KESH-it për kohëzgjatje prej 5 vjetësh ose më shumë, Banka do të zvogëlojë shumën e Këstit të saj B nëpërmjet shumës së përgjithshme të dhënë nga bankat tregtare ose nga institucionet e tjera financiare.	Për livrimin e Transhit B	KESH, realizuar menjëherë me pas livrimit te transhit A.

(K) Treguesit e Performancës së KESH-it:

Arkëtimet nga:	**2016**	**Afati i Këstit B**	**2018**	**2019**	**2020 e më pas**
OSHEE	95%	100%	100%	100%	105% derisa të jenë likuiduar të gjitha borxhet e prapambetura
Konsumatorët e tjerë	100%	100%	100%	100%	100%

5. Të sigurohet fleksibiliteti i nevojshëm për veprimtarinë operacionale-bankare të KESH, duke ruajtur vijueshmërinë e marrëdhënies me bankat e nivelit të dytë bazuar në historikun dhe performancën financiare dhe operacionale të marrëdhënies së KESH me këto banka, balancimin e arsyeshëm të kostove të borxhit, nivelin e ekspozimit dhe parimin e paritetit midis bankave.
6. Ngarkohet Administratori i KESH sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Duke parë tabelën e mëposhtme është respektuar kushti i OD me interes më të lartë shlyhen të parat.

Tabela nr. 5

Linjat e Kredive dhe OD-ve	Miratimi						
		Limiti OD	Norma interesit	Komision Rinovimi	P. në Vonesë	Shlyer 2018	Shlyer 2020
Intesa SanPaolo	Garanci Qeveritare	4,200,000,000Lek	3%	0.3%	3%	3,930,000,000	
	Garanci Qeveritare	1,000,000,000Lek	3%	0.3%	3%		
OD Raiffeisen Bank	Garanci Qeveritare	4,980,000,000Lek	B.Thesari 1vjecare+0.7%(min 3.91%)	0.1%	3%		
	Garanci Qeveritare	1,390,000,000Lek	B.Thesari 1vjecare+0.7%(min 3.91%)	0.1%	3%		
	Garanci Qeveritare	5,610,000,000Lek	B.Thesari 1vjecare+0.7%(min 3.91%)	0.1%	3%	7,430,000,000	6,125,000,000
	Garanci Qeveritare	1,081,047,000Lek	B. Thesari 1vjecare+0.7%(min 3.91%)	0.1%	3%	75,603,463	
	Garanci Qeveritare	3,577,500,000Lek	B.Thesari 1vjecare+0.7%(min 3.91%)	0.1%	3%		
	Garanci Qeveritare	33,000,000 ú	Euribor 1 vjecar+2.3%	0.3%	3%		
CL - Banka Kombetare Tregtare	Garanci Qeveritare	1,500,000,000Lek	Bono Thesari 12 mujore+1%	0.0%	4%	3,100,000,000	
	Garanci Qeveritare	1,600,000,000Lek	Bono Thesari 12 mujore+1%	0.0%	4%		
OD- Societe Generale	Garanci Qeveritare	6,000,000 ú	2.30%	0.00%	2.50%		

Burimi: KESH SHA

Pika 2.2.4. Mbi procesin e negocimit me bankat e nivelit të dytë për mundësinë e strukturimit të borxhit sipas termave të marrëveshjes me BERZH.

Nga ana e KESH SHA janë iniciuar procedurat që mbas bërjes efektive të tranzhit A në prill 2018 duke u testuar tregu i bankave të nivelit të dytë sipas kushteve të marrëveshjes por duke qenë se bërja efektive e tranzhit B vonoi për arsyet e sipërpërmendura negocimi me Intesa Sanpaolo Bank për ristrukturimin e kredisë sipas kushteve të BERZH ishte i pamundur e për rrjedhojë kjo procedure u rinis përsëri më 13.12.2019 duke testuar tregun mbas konfirmimit me shkresën nr. 22079 prot. datë 4.12.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për aktivizimin e tranzhit B.

Mbas testimit të tregut përsëri vetëm Intesa Sanpaolo Bank shprehu interes për strukturimin e OD në hua afatgjat sipas termave të huas me BERZH, ku me shkresën nr. 19/61483/1 prot., datë 19.12.2019 i kthen përgjigje pozitive KESH sha për sa i përket kërkesave:

-Afat maturimi deri në dhjetor 2031.

-Normë interesi Euribor 1 vjeçar +1% (në rast se Euribor është me vlerë negative, për efekt llogaritje të normës finale, ky indikator do të llogaritet i barabartë me 0 (zero).

-Shlyerja e kredisë afatgjatë do të jetë me këste të barabarta principali dhe interes i pagueshëm dy herë në vit (në muajt prill dhe tetor të çdo viti që kredia është e pashlyer).

Me shkresën nr. 20/14986 prot., datë 02.04.2020 pas konfirmimit të kushteve dhe nga banka mëmë Intesa sanpaolo Bank ka konfirmuar kushtet dhe është gati për negociimin në hartimin dhe lidhjen e kontratës.
Pas paraqitje së kontratës me Intesa Sanpaolo Bank, BERZH ka dhënë ñno objectionò për nënshkrimin e kontratës dhe vazhdimin e procedurës me shkresën nr. 965/4 prot., datë 14.07.2020. Është negociuar dhe pranuar dhe rënë dakord mes palëve duke pritur vetëm finalizimin e marrëveshjes.

2.3. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.
2.3.1. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në menaxhimin financiar të Projektit.
2.3.2. Mbi realizimin e disbursimeve të Projektit, në krahasim me disbursimet e planifikuara.
2.3.3. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në raportimet financiare dhe jo financiare.

1. Titulli i gjetjes:	Raportime jashtë afateve të parashikuara në Marrëveshjen e Huas.
Situata:	- Për vitet 2017-2019 KESH SHA ka hartuar Raporte Social Mjedisore sipas formatit të përcaktuara nga Huadhënësi, raporte të cilat janë dërguar pranë Huadhënësit jashtë afateve të parashikuara në seksionin 3.04, germa a, të Marrëveshjes së Huas konkretisht, për vitin 2017 raporti është dërguar katër muaj me vonesë nëpërmjet emali-t datës 03.07.2018, për vitin 2018 raporti është dërguar nëntëmbëdhjetë muaj me vonesë nëpërmjet emali-t të datë 21.10.2020, si dhe për vitin 2019 raporti është dërguar shtatë muaj me vonesë nëpërmjet emali-t të datës 21.10.2020. - Në lidhje me raportimin e pasqyrave finaciare të audituara nga një auditues i pëlqyeshëm nga Huadhënësi konstatohet se, KESH SHA për shkak të kësaj kërkese të huadhënësve të cilët janë Institucione Financiare Ndërkombëtarë, realizon auditim të pasqyrave me një grup audituesish të njohur nga këto institucione. Për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2017-2019 KESH SHA me fondet e veta nëpërmjet një procedure prokurimi ka lidhur kontratën nr. 5904/5 prot., datë 28.05.2018, me Shoqërinë ñE. & Y.ò me vlerë kontrate 27,468,000 lekë me TVSH. Për periudhën e audituar konstatohet se pasqyrat e raportuara për Huadhënësin kanë qenë vetëm pasqyrat e vitit 2017, të cilat janë dërguar pranë Bankës së bashku me raportin e auditimit sipas shkresës nr. 5856 prot., datë 14.11.2018. Pasqyrat e vitit 2018 dhe 2019 nuk janë raportuar pranë Huadhënësit për shkak se ato nuk kanë qenë të përfunduara. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se pasqyrat e vitit 2018, janë mbyllur nga Shoqëria ñE. & Y. ò në muajin Qershor të vitit 2020, por deri në muajin Shtator të këtij vitit raporti i audituesit të caktuar nuk ishte përfunduar. Ndërkohë pasqyrat financiare për vitin 2019 deri në muajin Shtator të vitit 2020 rezultojnë të pa mbyllura nga Shoqëria ñE. & Y.ò. Këto vonesa kanë ardhur si pasojë se procesi i ndjekur nga Shoqëria ñE. & Y.ò për realizimin e veprimeve rregulluese në pasqyrat e KESH SHA, bazuar në kualifikimet e lëna nga audituesit e këtyre pasqyrave, veprim ky me qëllim përmbushjen e detyrimit të KESH SHA si huamarrës pranë huadhënësve të tij. Në veçanti huadhënësve institucione financiare ndërkombëtare. KESH SHA ka kontraktuar nëpërmjet një granti, shërbim

	konsulence për realizimin e veprimeve rregulluese në pasqyrat financiare të tij. Shoqëria ñD.ò ka qenë shoqëria që ka dhënë këtë shërbim. Veprimet për rregullimin e pasqyrave financiare janë përfunduar në muajin Shkurt të vitit 2020 nëpërmjet miratimit të këtyre veprimeve nga ana e Këshillit Mbikëqyrës dhe në muajin Mars të vitit 2020 këto veprime janë miratuar dhe nga Asambleja e Aksionerëve. Vetëm pas këtyre rregullimeve shoqëria mundi të përmbyllte pasqyrat e vitit 2018. Kjo shtyrje në kohë solli edhe vonesë në paraqitjen dhe përfundimin e veprimtarisë së rivlerësimit të aseteve të KESH SHA, që zhvillohej paralel me datë rivlerësimi 01.01.2019. Rrjedhimisht këto vonesa kanë sjellë si efekt edhe shtyrjen e përfundimit të pasqyrave financiare të vitit 2019. Megjithatë nga ana e KESH SHA evidentohet se vonesat në raportimin e pasqyrave financiare ka qenë e njohur edhe nga Huadhënësi, për shkak se vetë veprimet rregulluese realizoheshin për qëllime të përmbushjes së detyrimeve me vetë huadhënësin dhe nuk kanë sjellë asnjë pengesë në ecurinë e disbursimeve të huasë. Vonesat nuk janë bërë shkak i shtyrjes së disbursimeve. Shkak kryesor kanë qenë kushtet e vendosura për tu përmbushur për qëllime disbursimi të Transhit A dhe B. Mos dërgimi i raporteve financiare dhe jo financiare, si dhe progresive në afatet kohore të parashikuara, ndikon në monitorimin e projektit sipas përcaktimeve, si dhe evidentimin e detyrimeve realizuara dhe të pa realizuara nga institucioni. Për sa më sipër veprime këto në kundërshtim të Ligjit nr. 125/2016, datë 15.12.2016, për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas për Projektin ñPlani i ristrukturimit të KESH-itò, seksioni 3.04, germa a, si dhe seksioni 4.01, pika 2, germa a.
Kriteri:	Ligji nr. 125/2016, datë 15.12.2016, për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas për Projektin ñPlani i ristrukturimit të KESH-itò konkretisht, - Seksioni 3.04, germa a, ñDuke filluar nga data e hyrjes në fuqi derisa shuma e plotë e Kredisë të jetë e shlyer ose anuluar, Huamarrësi do tõ dorëzojë Bankës raportet vjetore për Çështjet Mjedisore dhe Sociale që rrjedhin në lidhje me Huamarrësin ose me Projektin, siç referohen në seksionin 5.02 (c) (iii) të Afateve dhe Kushteve Standarde, brenda 60 ditëve pas përfundimit të vitit për të cilin do të raportohetò. - Seksioni 4.01, pika 2, germa a, ñJapë Bankës sa më shpejtë që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti financiar: a) kopje të vërtetuara të pasqyrave të tij financiare për atë vit pasi të jenë audituarò.
Ndikimi/Efekti:	Mos dërgimi i raporteve financiare dhe jo financiare, si dhe progresive në afatet kohore të parashikuara, ndikon në monitorimin e projektit sipas përcaktimeve, si dhe evidentimin e detyrimeve realizuara dhe të pa realizuara nga institucioni.
Shkaku:	Kjo vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi konkretisht, seksioni 3.04, germa a, seksioni 4.01, pika 2, germa a, të Ligjit nr. 125/2016, datë 15.12.2016, për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas për Projektin ñPlani i ristrukturimit të KESH-itò.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare në vijim të zbatimit të Projektit të

	marrë masat e nevojshme organizative dhe mbikëqyrëse, duke shmangur të gjitha praktikat penguese, për dërgimin e Raporteve Social Mjedisore si dhe të Raporteve të Auditimit të Pasqyrave Financiare pranë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim brenda afateve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

C. 1. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në menaxhimin financiar të Projektit.

Efektiviteti i Marrëveshjes së Huas:

Marrëveshja e Huas lidhur midis Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim me vlerë financimi prej 218,000,000 euro dhe me afat zbatimin e saj deri më datë 20.04.2021, e ratifikuar si pjesë e Ligjit nr. 125/2016, datë 15.12.2016, parashikonte që të bëhej efektive sipas kushteve të përcaktuara në seksionin 6.01, konkretisht sa më poshtë janë specifikuar për qëllimet e seksionit 9.02 (c) të afateve dhe Kushteve Standarde si dhe kushtet shtesë për efektivitetin e kësaj Marrëveshje si dhe të Marrëveshjes së Garancisë:

a) Secila nga detyrat e vendosura në Planin e Reformës si një zë për tû realizuar si ñCP për efektivitetinò do të jenë përfunduar në një përmbajtje të pëlqyeshme për Bankën.

b) Banka ka marrë një listë të Projekteve të investimeve për modernizimin dhe përmirësimet që rezultojnë në rritje të mbrojtjes mjedisore dhe/ose përmirësimet e eficiencës së energjisë për një shumë të përgjithshme të barabartë me të paktën 10 milionë euro e cila do të zbatohet nga Huamarrësi brenda 5 vjetëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

Si dhe evidentohet se efektiviteti është në vlerësim të Huadhënësit, i cili duhet të shprehet në formë të shkruar dhe në përputhje me rregullat e tija të brendshme referuar si Kushtet Standarde (Standard Terms). Efektiviteti i Marrëveshjes së Huas është shtyrë sipas shkresës së datës 15.06.2016, nga ana e Huadhënësit, ndërkohë që është konfirmuar nga ky i fundit nëpërmjet shkresës së datës 20.04.2018. Bërja efektive e Marrëveshjes së Huas është lidhur drejtpërdrejt me shprehjen e vullnetit të Huadhënësit i cili bazon konfirmimin e tij në dy pikat e mësipërme, dhe në vlerësimin nga ky i fundit si të pëlqyeshëm të realizimit të tyre. Në rastin e dhënë efektiviteti është shtyrë për një periudhë afërisht dy vitesh për shkak se nga ana e Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Enteve apo Institucioneve të tjera kërkohej veprim, të cilat nuk arritën të përmbushin kërkesat dhe kushtet e efektivitetit të pranuar kontraktualisht si dhe të ratifikuara me Ligj. Konkretisht nga ana e Enteve dhe Institucioneve të ngarkuara nuk u morën veprime për disa nga kushtet si më poshtë:

1. Detyra a) Kuadri ligjor.
2. Detyra b) Ristrukturimi i bilancit.

Për pikën b, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare arriti të nënshkruante një marrëveshje lidhur me ripagimin e detyrimeve të prapambetura me Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, akt i cili solli si rrjedhojë edhe bërjen efektive të Marrëveshjes së Huas pavarësisht se një pjesë e kushteve mbetën përsëri të pa përmbushura.

Amendimi i parë i Marrëveshjes së Huas ka ardhur si rrjedhojë e pamundësisë së palës së kushtëzuar për të bërë efektive Marrëveshjen me përmbushjen e plotë të kushteve të angazhuara. Midis palëve në amendimin nr. 1, datë 17.04.2018, është përcaktuar një kusht plotësues i njërit prej kushteve ekzistuese i cili lidhej me detyrën b, ristrukturimi i bilancit, me përmbushjen e të cilit BERZH do të detyrohej të bënte efektive Marrëveshjen e Huas, ndërsa KESH SHA do të detyrohej të nënshkruante marrëveshjen e përcaktuar që të kërkonte të drejtën e efektivitetit. Si

rrjedhojë e këtij ndryshimi, KESH SHA ka nënshkruar me palën OSHEE Marrëveshjen e ripagimit për detyrimet e prapambetura, akt i cili i jep KESH SHA të drejtën e pretendimit të efektivitetit dhe BERZH detyrimin për bërjen efektive të Huas. Nga zbatimi i procesit të disbursimit është konstatuar se, KESH SHA për shkak të normës së lartë të interesit, duhet të mbyllte të parat huat në monedhën lekë. Sipas përcaktimeve të seksionit 20.3 (b), disbursimet do të realizoheshin në euro për huat në monedhën euro ose në shuma për tërhequr në euro do të miratohen nga Huamarrësi dhe llogaria bankare dhe do t'i njoftohej Huadhënësit, pra duke e bërë të pa qartë procesin e shkëmbimit valutor. Duke qenë se procesi i shkëmbimit valutor nga euro në lekë do të realizohej nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, atëherë BERZH do të mund të disbursonte Huan drejtpërdrejt në lekë, në llogarinë e bankës që mbyllej. Për këtë arsye mes palëve u dakordësua amendimi nr. 2, datë 06.06.2018, i Marrëveshjes së Huas midis palëve.

C. 2. Mbi realizimin e disbursimeve të Projektit, në krahasim me disbursimet e planifikuara.
Procedurat të cilat duhen të ndiqen nga tërheqja e fondeve dhe deri tek përdorimi i tyre, janë parashikuar në Marrëveshjen e Huas si më poshtë:
Seksioni 2.02. Banka bie dakord që të gjitha kërkesat për pagesë të bëra nga Garantuesit në përputhje me këtë Marrëveshje, do të bëhen me shkrim dhe kërkesa për pagesë do të specifikojnë shumën e papaguar sipas Marrëveshjes së Huas që do të paguhet nga Garantuesi, e cila do të jetë në një datë jo më pak se tri ditë pune nga data e njoftimit për kërkesën.
Seksioni 2.03. b) Tërheqjet duhet të paguhen në llogaritë bankare të listuara në Skedulin 1 për llogaritë në euro. Për llogaritë në monedhat e tjera, shuma për t'u tërhequr në euro do të miratohet nga Huamarrësi dhe nga llogaria bankare dhe do ti njoftohet Bankës.

Referuar komunikimeve zyrtare Marrëveshja e Huas është bërë efektive në vitin 2018, ku disbursimi i parë për t'u përdorur në lidhje me shpenzimet e Projektit, ka qenë më datë 11.06.2018, në shumën 116,219,257.35 euro ose 14,460,000,000 lekë. Për periudhën e auditimit nga fillimi i Projektit deri më datë 30.09.2020, Projekti është në vitin e katërt të zbatimit të tij, ku Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka disbursuar shumën 168,000,000 euro ose 20,938,626,062.5 lekë pra është disbursuar 77% e Huas, konkretisht për Transhin e parë është disbursuar shuma 118,000,000 euro ose 14,687,906,062.5 lekë në masën 100% si dhe për Transhin e dytë është disbursuar shuma 50,000,000 euro ose 6,250,720,000 lekë në masën 50%. Referuar tabelës sa më poshtë janë trajtuar në mënyrë të hollësishme disbursimet e realizuar për periudhën e audituar.

Tabela nr. 6

Nr. i ap.	Lloji i Kështit	Banka	Data e aplikimit	Vlera e aplikuar (Lekë)	Vlera e aplikuar (Euro)	Data valuta e disbursimit	Vlera e disbursuar (Euro)	Vlera e disbursuar (Lekë)
1	Kësti A	Intesa San Paolo Bankë	06.06.2018	14,460,000,000	116,219,257.35	11.06.2018	31,586,561.65	3,930,000,000
		Banka Kombëtare Tregtare					24,915,608.42	3,100,000,000
		Raiffeisen Bankë					59,717,087.28	7,430,000,000
2		Raiffeisen Bankë	11.07.2018	75,603,462.50	600,742.65	17.07.2018	600,742.65	75,603,462.50
3	Kësti B	Raiffeisen Bankë	08.04.2020	6,125,000,000	49,000,000	14.04.2020	49,000,000	6,125,000,000
1	Kësti A	Front&FEE				14.04.2018	1,180,000	152,302,600
3	Kësti B					14.04.2020	1,000,000	125,720,000

Totali	**20,660,603,462**	**165,820,000**		**168,000,000**	**20,938,626,062.5**

Burimi : Korporata Elektroenergjitike Shqiptare

Për sa trajtuar sa më sipër konstatohet se, pjesë e skemës së financimit sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huas, janë katër banka të nivelit të dytë konkretisht, Intesa San Paolo Bankë, Raiffeisen Bankë, Banka Kombëtare Tregtare dhe Societe General Bankë (OTP). Disbursimi i overdrafteve si dhe lëvrimi i shumave në llogari të përfituesve final (bankat e nivelit të dytë të përmendura sa më sipër) është kryer konformë kësaj procedure konkretisht si më poshtë:
KESH SHA i drejtohet me anë të kërkesës për aplikim për disbursim BERZH për pjesët takuese sipas kësteve të parashikuara në Marrëveshje. Mbi bazën e aplikimit BERZH kryen disbursimin duke kaluar fondet në llogari të përfituesve final, ku konfirmohet disbursimi me anë të dokumentacionit bankar (Lon Drawdown Advice). Nga ky moment KESH SHA informon Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe përfituesit final lidhur me disbursimin e kryer. Më pas përfituesit final me shkresat respektive konfirmojnë transfertën e realizuar si dhe uljen ose mbylljen e linjës OD (overdrafteve) sipas rastit për pjesët takuese duke njoftuar njëkohësisht Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe KESH SHA.
Pagesat e kësteve dhe interesave:
Procedurat të cilat duhet të ndiqen nga KESH SHA për shlyerjen e kësteve të Huas si dhe pagesat mbi normat e interesit janë përcaktuar në kriteret e Marrëveshjes së Huas si më poshtë:
Seksioni 2.02, germa (e). (1) Huamarrësi do të shlyejë Kredinë në 28 këste të barabarta gjashtëmujore (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) më 10 prill dhe 10 tetor të çdo viti me datën e parë të shlyerjes të Kredisë që do të jetë 10 tetor 2017 dhe me datën e fundit të shlyerjes së Kredisë që do të jetë 10 prill 2031.
Seksioni 2.02. germa (g). Huamarrësi do tõ paguajë Bankës Tarifën e Angazhimit prej 0.5% në vit, mbi totalin e shumës së disponueshme për çdo këst. Tarifa do të mblidhet që nga data gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së Marrëveshjes së Kredisë dhe Tarifa e Angazhimit për këstin B do të mblidhet që nga data gjashtëdhjetë (60) ditë pas datë në të cilën Banka konfirmon me shkrim disponueshmërinë e këstit B dhe do të mblidhet dhe llogaritet në të njëjtën bazë të interesit sipas Seksionit 3.04 (b) (ii).
Seksioni 2.02. germa h). Huamarrësi do të paguajë Bankës një komision fillim-mbarim të barabartë me një përqind (1%) (ose një shumë tjetër të tillë të specifikuara në Marrëveshjen e Kredisë) të shumës së pricnipalit për çdo këst. Për Këstin A, ai do të paguhet pas përmbushjes së kushteve për hyrjen në fuqi sipas afateve dhe kushteve standarde, për këstin B, ai do të paguhet pas përmbushjes së kushteve të vendosura në njoftimin me shkrim për Huamarrësin, i cili është referuar në pikën 2.01 (c).

Tabela nr. 7 Euro

Afati për pagesat e Kredisë	10.10.2018	10.04.2019	10.10.2019	10.04.2020	**Totali**
Data konfirmimit nga BERZH	20.09.2018	12.03.2019	19.09.2019	27.03.2020	
Shkresa protokolluar në KESH SHA	nr. 5088 prot., datë 02.10.2018	nr. 1535 prot., datë 21.03.2019	nr. 4137 prot., datë 03.10.2019	nr. 1034 prot., datë 03.04.2020	
Interes Kredie	397,534.24	573,611.11	553,692.31	542,220.09	2,067,057.75
Principal/Llog 468162	4,538,461.54	4,538,461.54	4,538,461.54	4,538,461.54	18,153,846.16
Komisione Angazhimi Front&Fee	1,066,455.10	-	-	100,000	1,166,455.1
Totali	**6,002,450.88**	**5,112,072.65**	**5,092,153.85**	**5,180,681.63**	**21,387,359.01**

Burimi : Korporata Elektroenergjitike Shqiptare

Për sa trajtuar sa më sipër konstatohet se, pagesat lidhur me shlyerjen e Huas, janë kryer sipas afateve të parashikuara në seksionet e përmendura sa më sipër të Marrëveshjes së Huas.

Regjistrimi në kontabilitet:
Për sa i përket regjistrimit në kontabilitet të Huas së financuar nga BERZH me numër veprimi 48132 në lidhje me mbulimin e overdrafteve, KESH SHA përdor sistemin e kompjuterizuar ALPHA, ku regjistrimi kryhet në llogarinë ñDetyrime të huave afatgjataò 468162, e cila kreditohet për pjesën e disbursimeve dhe debitohet për pjesën e pagesave të këstit të principalit të Kredisë. Në llogarinë e ñDetyrimeve për interesin e maturuar të huas afatgjatëò 48600136, regjistrohet pjesa e interesit të secilit gjashtëmujor në momentin e ardhjes së njoftimit për pagesë nga BERZH dhe më pas kryhen pagesat dhe mbyllet detyrimi tek kjo llogari.

C. 3. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në raportimet financiare dhe jo financiare.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me ndjekjen e procedurave ligjore në raportimet financiare dhe jo financiare u konstatua se,
Raportimet drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për konfirminin e disbursimeve të realizuara në llogaritë respektive të Bankave të cilat janë pjesë e skemës së financimit referuar Marrëveshjes së Huas si më poshtë:
Transhi i Parë Kësti A
1. Me shkresën nr. 3151 prot., datë 24.05.2018, KESH SHA ka kryer aplikimin drejt BERZH-it për disbursimin e pjesës takuese për Kështin A në shumën 14,460,000,000 lekë. Me dokumentin bankar (Loan Drawdown Advice) BERZH ka konfirmuar se më datë 11.06.2018, ka kryer disbursimin duke kaluar në llogari të përfituesve final (bankat e nivelit të dytë) shumën 14,460,000,000 lekë. Lidhur me këtë situatë KESH SHA është drejtuar Intesa San Paolo Bankë, Bankës Kombëtare Shqiptare dhe Raiffeisen Bankë me shkresat respektive konkretisht, shkresën nr. 3253 prot., datë 11.06.2018, shkresën nr. 3254 prot., datë 11.06.2018, si dhe shkresën nr. 3255 prot., datë 11.03.2018, për konfirmimin e kalimit në llogaritë e bankave disbursimet e kryera. Me shkresën nr. 3653 prot., datë 02.07.2018, Banka Intesa San Paolo konfirmon dhe informon MFE dhe KESH SHA se në llogarinë e saj ka kaluar disbursimi në shumën 3,930,000,000 lekë financim nga BERZH. Me shkresën nr. 3774 prot., datë 05.07.2018, Banka Kombëtare Tregtare konfirmon dhe informon MFE dhe KESH SHA se në llogarinë e saj ka kaluar disbursimi në shumën 3,100,000,000 lekë financim nga BERZH. Me shkresën nr. 3542 prot., datë 26.06.2018, Raiffeisen Bankë konfirmon dhe informon MFE dhe KESH SHA se në llogarinë e saj ka kaluar disbursimi në shumën 5,610,000,000 lekë financim nga BERZH si dhe me shkresën nr. 19601 prot., datë 19.06.2018, Raiffeisen Bankë konfirmon dhe informon MFE dhe KESH SHA se në llogarinë e saj ka kaluar disbursimi në shumën 1,820,000,000 lekë financim nga BERZH.
2. Me shkresën nr. 3151/1 prot., datë 11.07.2018, KESH SHA ka kryer aplikimin drejt BERZH-it për disbursimin e pjesës takuese për Kështin A në shumën 600,742.65 euro. Me dokumentin bankar (Loan Drawdown Advice) BERZH ka konfirmuar se më datë 18.06.2018, ka kryer disbursimin duke kaluar në llogari të përfituesit final Raiffeisen Bankë, shumën 600,742.65 euro. Lidhur me këtë situatë KESH SHA është drejtuar Raiffeisen Bankë me shkresën nr. 4097 prot., datë 19.07.2018, për konfirmimin e disbursimit të kryer. Me shkresën nr. 24317 prot., datë 06.08.2018, Raiffeisen Bankë konfirmon dhe informon MFE dhe KESH SHA se në llogarinë e saj ka kaluar disbursimi në shumën 600,743 euro financim nga BERZH.
Transhi i Dytë Kësti B
1. Me shkresën nr. 1040/1 prot., datë 08.04.2020, KESH SHA ka kryer aplikimin drejt BERZH-it për disbursimin e pjesës takuese për Kështin B në shumën 6,125,000,000 lekë. Me dokumentin bankar (Loan Drawdown Advice) BERZH ka konfirmuar se më datë 14.04.2020, ka kryer

disbursimin duke kaluar në llogari të përfituesit final Raiffeisen Bankë shumën 6,125,000,000 lekë. Lidhur me këtë situatë KESH SHA është drejtuar Raiffeisen Bankë me shkresën nr. 1099 prot., datë 14.04.2020, për konfirmimin e disbursimit të kryer. Me shkresat respektive Raiffeisen Bankë konfirmon dhe informon MFE dhe KESH SHA se në llogarinë e saj kanë kaluar disbursimet konkretisht, me shkresën nr. 9773 prot., datë 23.04.2020, shuma 1,390,000,000 lekë, me shkresën nr. 9772 prot., datë 23.04.2020, shuma 4,980,000,000 lekë dhe shkresën nr. 9724 prot., datë 23.04.2020, shuma 2,838,547,000 lekë.
2. Me shkresën nr. 2928/5 prot., datë 01.10.2020, KESH SHA ka kryer aplikimin drejt BERZH-it për disbursimin e pjesës e pjesës së mbetur për Këstin B në shumën totale 39,743,094 euro ose (shumat respektive sipas Bankave të nivelit të dytë si pjesë e skemës së financimit, shumën 18,786,753 euro dhe 2,583,547,000 lekë). Me dokumentet bankare (Loan Drawdown Advice) respektive BERZH ka konfirmuar se më datë 06.10.2020, ka kryer disbursimin duke kaluar në llogari të përfituesit final OTP Bankë shumën 18,786,753 euro si dhe më datë 06.10.2020, ka kaluar në llogari të përfituesit final Raiffeisen Bankë shumën 2,583,547,000 lekë. Lidhur me këtë situatë KESH SHA është drejtuar OTP Bankë me shkresën nr. 2928/6 prot., datë 06.10.2020, si dhe Raiffeisen Bankë me shkresën nr. 2928/7 prot., datë 07.10.2020, për disbursimin e kryer. Me shkresat respektive OTP Bankë dhe Raiffeisen Bankë konfirmon dhe informon MFE dhe KESH SHA se në llogaritë e tyre kanë kaluar disbursimet konkretisht, me shkresën nr. 2986 prot., datë 22.10.2020, shuma 18,786,753 euro si dhe shkresën nr. 23559 prot., datë 23.10.2020, shuma 2,583,547,000 lekë.
Si dhe,
- Për vitet 2017-2019 KESH SHA ka hartuar Raporte Social Mjedisore sipas formatit të përcaktuara nga Huadhënësi, raporte të cilat janë dërguar pranë Bankës jashtë afateve të parashikuara në seksionin 3.04, germa a, të Marrëveshjes së Huas konkretisht, për vitin 2017 raporti është dërguar katër muaj me vonesë nëpërmjet emali-t datës 03.07.2018, për vitin 2018 raporti është dërguar nëntëmbëdhjetë muaj me vonesë nëpërmjet emali-t të datë 21.10.2020, si dhe për vitin 2019 raporti është dërguar shtatë muaj me vonesë nëpërmjet emali-t të datës 21.10.2020, veprime këto në kundërshtim të Ligjit nr. 125/2016, datë 15.12.2016, për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas për Projektin ñPlani i ristrukturimit të KESH-itò, seksioni 3.04, gërma a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, ñDuke filluar nga data e hyrjes në fuqi derisa shuma e plotë e Kredisë të jetë e shlyer ose anuluar, Huamarrësi do tõi dorëzojë Bankës raportet vjetore për Çështjet Mjedisore dhe Sociale që rrjedhin në lidhje me Huamarrësin ose me Projektin, siç referohen në seksionin 5.02 (c) (iii) të Afateve dhe Kushteve Standarde, brenda 60 ditëve pas përfundimit të vitit për të cilin do të raportohetò.
- Në referencë të përcaktimeve të seksionit 3.02, germa c, të Marrëveshjes së Huas, KESH SHA duhet të ñNë vitin 2019 dhe çdo tre vjet kalendarike pas datës 31 korrikut të atij viti, Huamarrësi do të prokurojë me shpenzimet e tij që: (1) të kryhet një auditim mjedisor, social, shëndetësor dhe i sigurisë së Projektit, nga një ekspert i pavarur i caktuar nga Huamarrësi sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën dhe (2) rezultatet e këtij auditimi tõi dorëzohen Bankësò. Për këtë arsye nëpërmjet procedurës së prokurimit nr. Reference 23748-05272019, KESH SHA me fondet e veta ka iniciuar procedurën e prokurimit për ñShërbim Auditimi Mjedisor Social dhe Sigurisë dhe Shëndetit në Punëò sipas kërkesës së kontratës së huas. Në përfundim të procedurës është lidhur kontrata me nr. 2410/6 prot., datë 28.10.2019, me subjektin ñVielf Studioò në përputhje me parashikimet e seksionit të sipërpërmendur me vlerë kontrate 5,400,000 lekë me TVSH. Termat e referencës së këtij shërbimi janë konfirmuar nga BERZH nëpërmjet emali-t të datës 16.04.2019. Rezultatet e këtij auditimi janë dërguar pranë BERZH nëpërmjet emali-t të

datës 17.03.2020, në përmbushje të detyrimeve të seksionit 3.02, germa c, të Marrëveshjes së Huas.
- Në lidhje me raportimin e pasqyrave finaciare të audituara nga një auditues i pëlqyeshëm nga Huadhënësi konstatohet se, KESH SHA për shkak të kësaj kërkese të huadhënësve të cilët janë Institucione Financiare Ndërkombëtarë, realizon auditim të pasqyrave me një grup audituesish të njohur nga këto institucione. Për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2017-2019 KESH SHA me fondet e veta nëpërmjet një procedure prokurimi ka lidhur kontratën nr. 5904/5 prot., datë 28.05.2018, me Shoqërinë ñE. & Y.ò me vlerë kontrate 27,468,000 lekë me TVSH. Për periudhën e audituar konstatohet se pasqyrat e raportuara për Huadhënësin kanë qenë vetëm pasqyrat e vitit 2017, të cilat janë dërguar pranë Bankës së bashku me raportin e auditimit sipas shkresës nr. 5856 prot., datë 14.11.2018. Pasqyrat e vitit 2018 dhe 2019 nuk janë raportuar pranë Huadhënësit për shkak se ato nuk kanë qenë të përfunduara. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se pasqyrat e vitit 2018, janë përfunduar nga Shoqëria ñE. & Y.ò në muajin Qershor të vitit 2020, por deri në muajin Shtator të këtij vitit raporti i audituesit të caktuar nuk ishte përfunduar. Ndërkohë pasqyrat financiare për vitin 2019 deri në muajin Shtator të vitit 2020 rezultojnë të pa përfunduara nga Shoqëria ñE. & Y.ò. Këto vonesa kanë ardhur si pasojë se procesi i ndjekur nga Shoqëria ñE.& Y.ò për realizimin e veprimeve rregulluese në pasqyrat e KESH SHA, bazuar në kualifikimet e lëna nga audituesit e këtyre pasqyrave, veprim ky me qëllim përmbushjen e detyrimit të KESH SHA si huamarrës pranë huadhënësve të tij. Në veçanti huadhënësve institucione financiare ndërkombëtare. KESH SHA ka kontraktuar nëpërmjet një granti, shërbim konsulence për realizimin e veprimeve rregulluese në pasqyrat financiare të tij. Shoqëria ñD.ò ka qenë shoqëria që ka dhënë këtë shërbim. Veprimet për rregullimin e pasqyrave financiare janë përfunduar në muajin Shkurt të vitit 2020 nëpërmjet miratimit të këtyre veprimeve nga ana e Këshillit Mbikëqyrës dhe në muajin Mars të vitit 2020 këto veprime janë miratuar dhe nga Asambleja e Aksionarëve. Vetëm pas këtyre rregullimeve shoqëria mundi të përmbyllte pasqyrat e vitit 2018. Kjo shtyrje në kohë solli edhe vonesë në paraqitjen dhe përfundimin e veprimtarisë së rivlerësimit të aseteve të KESH SHA, që zhvillohej paralel me datë rivlerësimi 01.01.2019. Rrjedhimisht këto vonesa kanë sjellë si efekt edhe shtyrjen e përfundimit të pasqyrave financiare të vitit 2019. Megjithatë nga ana e KESH SHA evidentohet se vonesat në raportimin e pasqyrave financiare ka qenë e njohur edhe nga Huadhënësi, për shkak se vetë veprimet rregulluese realizoheshin për qëllime të përmbushjes së detyrimeve me vetë huadhënësin dhe nuk kanë sjellë asnjë pengesë në ecurinë e disbursimeve të huasë. Vonesat nuk janë bërë shkak i shtyrjes së disbursimeve. Shkak kryesor kanë qenë kushtet e vendosura për tu përmbushur për qëllime disbursimi të Transhit A dhe B. Për sa trajtuar më sipër mos raportimi dhe dërgimi i raporteve të auditimit për pasqyrat financiare të KESH SHA jashtë afateve të parashikuara në Marrëveshjen e Huas pranë BERZH, bie në kundërshtim të Ligjit nr. 125/2016, datë 15.12.2016, për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas për Projektin ñPlani i ristrukturimit të KESH-itò, seksion 4.01, pika 2, germa a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, ñJapë Bankës sa më shpejtë që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti financiar: a) kopje të vërtetuara të pasqyrave financiare për atë vit pasi të jenë audituarò.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në ligjin nr. 125/2016, është ratifikuar marrëveshja ñPër ratifikimin e marrëveshjen e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropianë për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), në lidhje me marrëveshjen e Huas ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Bankës Evropiane për Zhvillim (BERZH), për Projektin ñShqipëria: Plani i strukturimit të KESHò, seksioni 1.02 ñPërkufizimetò, paragraf 2, përcaktohet: ñ*Përfaqësues i autorizuar i huamarrësit do të thotë Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Huamarrësit*ò. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, në lidhje me menaxhimin e projektit, organizimi është bërë sipas departamenteve përkatëse dhe jo nga një organ i krijuar i cili të mbulojë të gjitha fushat e përfshira në zbatimin e projektit. Po ashtu, nuk është krijuar një njësi, e cila do të zbatonte, menaxhonte apo koordinonte aktivitetin e projektit, duke patur parasysh se në zbatimin e programit për mundësimin e huas, janë të përfshirë edhe institucione të tjerë si Enti Rregullator i Energjisë dhe OSHEE *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: KESH SHA të marrë masa për ngritjen e strukturave të menaxhimit për projektet në vazhdimësi, me synim zbatimin me korrektësi të përcaktimeve në marrëveshjet me huadhënësin, si dhe me cilësinë dhe afatin e parashikuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, nuk është realizuar ndonjë procedurë për analizimin e kostos dhe përfitimit nga huaja, detyrim i përcaktuar në Marrëveshjen e financimit, seksionin 4.01.a *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: KESH SHA të marrë masa për analizimin e kostos dhe përfitimeve nga marrja e huas dhe shlyerja e overdrafteve të përcaktuara. Të nxirren përgjegjësitë për vonesat e shkaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportimin e pasqyrave financiare të audituara nga një audites i pëlqyeshëm nga Huadhënësi konstatohet se, KESH SHA për shkak të kësaj kërkese të huadhënësve të cilët janë Institucione Financiare Ndërkombëtarë, realizon auditim të pasqyrave me një grup audituesish të njohur nga këto institucione. Për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2017-2019 KESH SHA me fondet e veta nëpërmjet një procedure prokurimi ka lidhur kontratën nr. 5904/5 prot., datë 28.05.2018, me Shoqërinë ñE. & Y.ò me vlerë kontrate 27,468,000 lekë me TVSH. Për periudhën e audituar konstatohet se pasqyrat e raportuara për Huadhënësin kanë qenë vetëm pasqyrat e vitit 2017, të cilat janë dërguar pranë Bankës së bashku me raportin e auditimit sipas shkresës nr. 5856 prot., datë 14.11.2018. Pasqyrat e vitit 2018 dhe 2019 nuk janë raportuar pranë Huadhënësit për shkak se ato nuk kanë qenë të përfunduara. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se pasqyrat e vitit 2018, janë mbyllur nga Shoqëria ñE. & Y.ò në muajin Qershor të vitit 2020, por deri në muajin Shtator të këtij vitit raporti i audituesit të caktuar nuk ishte përfunduar. Ndërkohë pasqyrat financiare për vitin 2019 deri në muajin Shtator të vitit 2020 rezultojnë të pa mbyllura nga Shoqëria ñE. & Y.ò. Këto vonesa kanë ardhur si pasojë se procesi i ndjekur nga Shoqëria ñE. & Y.ò për realizimin e veprimeve rregulluese në pasqyrat e KESH SHA, bazuar në kualifikimet e lëna nga audituesit e këtyre pasqyrave, veprim ky me qëllim përmbushjen e detyrimit të KESH SHA si huamarrës pranë huadhënësve të tij. Në veçanti

huadhënësve institucione financiare ndërkombëtare. KESH SHA ka kontraktuar nëpërmjet një granti, shërbim konsulence për realizimin e veprimeve rregulluese në pasqyrat financiare të tij. Shoqëria ñD.ò ka qenë shoqëria që ka dhënë këtë shërbim. Veprimet për rregullimin e pasqyrave financiare janë përfunduar në muajin Shkurt të vitit 2020 nëpërmjet miratimit të këtyre veprimeve nga ana e Këshillit Mbikëqyrës dhe në muajin Mars të vitit 2020 këto veprime janë miratuar dhe nga Asambleja e Aksionarëve. Vetëm pas këtyre rregullimeve shoqëria mundi të përmbyllte pasqyrat e vitit 2018. Kjo shtyrje në kohë solli edhe vonesë në paraqitjen dhe përfundimin e veprimtarisë së rivlerësimit të aseteve të KESH SHA, që zhvillohej paralel me datë rivlerësimi 01.01.2019. Rrjedhimisht këto vonesa kanë sjellë si efekt edhe shtyrjen e përfundimit të pasqyrave financiare të vitit 2019. Megjithatë nga ana e KESH SHA evidentohet se vonesat në raportimin e pasqyrave financiare ka qenë e njohur edhe nga Huadhënësi, për shkak se vetë veprimet rregulluese realizoheshin për qëllime të përmbushjes së detyrimeve me vetë huadhënësin dhe nuk kanë sjellë asnjë pengesë në ecurinë e disbursimeve të huas. Vonesat nuk janë bërë shkak i shtyrjes së disbursimeve. Shkak kryesor kanë qenë kushtet e vendosura për tu përmbushur për qëllime disbursimi të Transhit A dhe B. Mos dërgimi i raporteve financiare dhe jo financiare, si dhe progresive në afatet kohore të parashikuara, ndikon në monitorimin e projektit sipas përcaktimeve, si dhe evidentimin e detyrimeve realizuara dhe të pa realizuara nga institucioni. Për sa më sipër veprime këto në kundërshtim të Ligjit nr. 125/2016, datë 15.12.2016, për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas për Projektin ñPlani i ristrukturimit të KESH-itò, seksioni 3.04, germa a, si dhe seksioni 4.01, pika 2, germa a *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 25-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare në vijim të zbatimit të Projektit të marrë masat e nevojshme organizative dhe mbikëqyrëse, duke shmangur të gjitha praktikat penguese, për dërgimin e Raporteve Social Mjedisore si dhe të Raporteve të Auditimit të Pasqyrave Financiare pranë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim brenda afateve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas.

Në vijimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Marrëveshjes së Huasë së EBRD të ratifikuar me Ligjin Nr. 125/2016 "Për projektin" Shqipëria: Plani i Ristrukturimit të KESH-it" rezulton se, KESH SHA ka paguar **548,277,597 lekë** interesa overdraftesh si rezultat i mos plotësimit në kohë të kushteve të vëna nga banka për bërjen efektive të parave, vlerë e cila **e cila përbën efekt negative financiar për buxhetin e shoqërisë** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: KESH SHA në të gjitha rastet të tregojë angazhim maksimal në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave apo kushteve të përcaktuara në marrëveshje si dhe te nxisë organet e tjera për plotësimin e tyre sipas rastit, me qëllim respektimin e afateve të miratuara për mënjanimin e kostove shtesë në këtë projekt të cilat deri në këtë fazë arrijnë vlerën **548,277,597 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, KESH SHA nuk ka përllogaritur humbjen që i shkaktohet nga tarifa e angazhimit për të cilën KESH SHA ka paguar shumën prej **1,066,455 Euro pas lëvrimit të tranzhit A vlerë e cila përbën efekt negative financiar për buxhetin e shoqërisë**. Për tranzhin A, KESH SHA iu kanë rritur kostot me tarifën e angazhimit si rezultati i tërheqjes me vonesë të shumës së akorduar si rezultat i mos plotësimit të kushteve të vëna nga banka, kryesisht të kushteve të tregut energjetik për tu plotësuar nga ERE, rakordimin me detyrimet që OSHEE ka ndaj KESH, rritjen e çmimit të shitjes së energjisë nga KESH sha e cila miratohet nga ERE, etj. Për Tranzhin B KESH SHA i janë rritur kostot me tarifën e angazhimit si rezultati i tërheqjes me vonesë prej 72 ditësh sipas shkresës nr. 1034 datë 03.04.2020 të EBRD me **100,000 Euro. (**100,000,000 Euro x (72/360 x 0.5%) = 100,000 Euro.**)**
Është vepruar në kundërshtim me Nenin 2 ñAfatet Kryesore të Huasëò, Seksionin 2.02 Afate të tjera Financiare të kredisë pika *g) Huamarrësi do ti paguajë Bankës tarifën e angazhimit prej 0.5% në vit mbi totalin e shumës së disponueshme për çdo këst*. Tarifa e angazhimit për Kështin A do të mblidhet që nga data gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së Marrëveshjes të Kredisë dhe Tarifa e angazhimit për Kështin B do të mblidhet që nga data gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës në të cilën Banka konfirmon me shkrim disponueshmërinë e Kështit B dhe do të mblidhet dhe llogaritet në të njëjtën bazë të interesit sipas Seksionit 3.04 (b)(ii) *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>2.1 Rekomandimi:</u> KESH SHA të marrë masa për angazhim maksimal në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave apo kushteve të përcaktuar si dhe te nxisë organet e tjera për plotësimin e detyrimeve të tyre të adresuara nga zbatimi i marrëveshjes, me qëllim respektimin e afateve dhe mënjanimin e kostove shtesë në këtë projekt të cilat kanë krijuar efekt financiar negativ në vlerën **1,166,455 Euro**.

Në vijimësi

C. VLERA TË RIKUPERUESHME

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për Tranzhin B, huamarrësi KESH SHA ka përdorur vetëm 89,740,094 Euro nga vlera e akorduar prej 100,000,000 Euro, ndërsa komisionet nga ana e huadhënësit janë mbajtur mbi vlerën e plotë dhe jo atë të lëvruar. Diferencën prej 10,259,906 Euro të palëvruara KESH SHA e ka negociuar me Intesa Sanpaolo Bank duke e strukturuar OD sipas kushteve të marrëveshjes me BERZH. Komisioni fillim mbarim që BERZH duhet të mbante nga TRANZHI B llogaritet në 89,740,094 Euro x 1% = 897,401 Euro ndërkohë që është mbajtur vlera prej 1,000,000 Euro ose **102,599 Euro më tepër.** Mbajtja e komisioneve bëhet sipas Nenit 2 ñAfatet Kryesore të Huasò, Seksionin 2.02 ñAfate të tjera Financiare të kredisëò, pika h), *huamarrësi do ti paguajë bankës një komision fillim-mbarim të barabartë me një përqind (1%) të shumës së principalit për çdo këst (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>1.1 Rekomandimi:</u> KESH SHA të marrë masat e nevojshme me Huadhënësin për rakordimin e shumave të mbajtura për komisionet e huasë, fillim-mbarim, dhe rikuperimin e vlerës prej **102,599 Euro** gjatë pagesave në vijim duke kryer dhe sistemimet përkatëse.

Menjëherë

V. ANEKSE

1. Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
SHA	Shoqëri aksionare
SHPK	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
AQT	Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
TAP	Tatimi i të ardhurave nga punësimi
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
OD	Overdraft

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT
A. T.
S. H.
M. H.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT
(I autorizuar)
K. XH.